

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 82-të i botimit
Nr. 5



5 MAJ

Dita e Dëshmorëve, jo vetëm
simbol, por edhe premtim...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 82-të i botimit



ADRESA:

Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitimi, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

*Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:
<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>*

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 82-të i botimit
Nr.4 prill 2014



Përmbajtja

Numri 5

CUBIC

- 18** Parimet e menaxhimit të burimeve njerëzore: Një perspektivë amerikane

NDËRKOMBËTARE

- 22** Opsionet e SHBA-së për sanksionet e paefektshme ndaj Rusisë

SIGURIA

- 42** Kronologjia e krizës së Ukrainës

KOMBI

- 46** Autoktonia e shqiptarëve

HISTORI

- 48** Një legjendë trimërie në tempullin e historisë së Shqipërisë

STAFI

Kryeredaktor:
Albert HITOALIAJ

Gazetarë:
Mimioza GOLIKJA
Alba MUSARAJ

Redaktore korrektore:
Elona Shimaj MAKO

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

4 5 MAJ

Dita e Dëshmorëve, jo vetëm simbol, por edhe premtim...

Me rastin e 5 majit, ditës së Dëshmorëve të Atdheut, ministrja e Mbrojtjes...



6 "ZALL-DAJTI 14"

Testohen kapacitetet e FT, për përballimin e emergjencave civile

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA...



15 SIGURIA

Interesat kombëtare, siguria kombëtare dhe marrëdhëniet mes tyre

Marrëdhëniet midis interesave kombëtare dhe sigurisë kombëtare janë shumë të rëndësishme në kohën...



28 SPECIALE

Koalicioni Antifashist dhe fitorja e popujve mbi fashizmin

69-vjetori i Koalicionit Antifashist dhe i fitores së popujve mbi fashizmin na shtyn të ritheksojmë e të ngremë...



DITA E DESHMORËVE



5 maj

Dita e Dëshmorëve, jo vetëm simbol, por edhe premtim...

Me rastin e 5 majit, ditës së Dëshmorëve të Atdheut, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo zhvilluan homazhe dhe vendosën kurorë me lule pranë monumentit "Nënë Shqipëri" në Varrëzat e Dëshmorëve të Atdheut. Pas përfundimit të ceremonisë, para monumentit "Nënë Shqipëri", ministrja e Mbrojtjes Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bazo bënë homazhe dhe vendosën kurora me lule pranë varrezave dhe prehen trupat e pilotëve që kanë shërbyer në Forcat e Armatosura dhe kanë dhënë jetën e tyre në krye të detyrës. Më pas, ata u takuan me familjarë dhe të afërm të dëshmorëve të Forcave të Armatosura, që kishin ardhur për të bërë homazhe dhe përkujtuar të afërmit e tyre. Në 63 vitet e fundit, që nga data e krijimit, në Armën e Aviacionit kanë shërbyer disa dhjetëra e qindra pilotë, të cilët ishin teknikë dhe ushtarakë të zotë dhe të talentuar, që i dhanë emër dhe krenari kësaj arme në të gjithë vendin. Sot, 36 prej atyre pilotëve, tyre kanë rënë në krye të detyrës dhe janë Dëshmorë të Atdheut, duke u gjetur prehje në Varrëzat e Dëshmorëve të Kombit. Numri i lartë i dëshmorëve të FA, në kohë paqesje, tregon se FA nuk janë gjithnjë në "qetësi" dhe se

momenti fatal mund të jetë më pranë se sa duket. Kjo u dëshmuar më së miri në rastin e Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli, i cili e dha jetën në një kohë paqesje e qetësie për vendin, - por që luftoi për hir të interesave kombëtarë dhe atyre të vendeve të Aleancës, duke synuar sjelljen e paqes në Afganistan. Ai është dëshmori i fundit në altarin e kombit, por jo i vetmi nga pjesëtarët e FA që dhanë jetën për të realizuar misionin e tyre - cilido qoftë ai, në çdo kohë e çdo vend.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Kodheli, në vizitën e saj të parë që kreu në Afganistan, teksa ishte në bazën ku qëndrojnë efektivat e FS shqiptare të "Eagle 8" tha ndër të tjera: "Ajo që ju bëni nuk matet me para, sepse ju vini jetën në rrezik dhe jeta nuk ka çmim. Unë e kam vënë dorën mbi Kushtetutë. Edhe ju e keni vënë dorën mbi një flamur ku jeni betuar. Dhe do t'i rrimë kësaj bese deri në fund. Atdheu, do t'ju jetë gjithmonë në borxh, sado që t'ju paguaj, sepse ajo që bëni ju nuk matet me para".

Ky vlerësim i dhënë për këta kontingjente nga ministrja Kodheli, është një formë premtimi që i bëhet këtyre ushtarakëve, të cilët kryejnë me devotshmëri një mision sa fisnik edhe të rrezikshëm, i cili mbart në vete tension e guxim, por që mbi çdo gjë tjetër, mbart Vlerë...



DITA E DËSHMORËVE

Ministrja Kodheli dhe gjeneralmajor Bazo, kryen homazhe pranë varrezave ku prehen trupat e pilotëve që kanë shërbyer në Forcat e Armatosura dhe kanë dhënë jetën e tyre në krye të detyrës.

“ZALL-DAJTI 14”

Testohen kapacitetet e FT, për përballimin e emergjencave civile

Ministrja Kodheli inspekton stërvitjen e Batalionit të Dytë të Këmbësisë në rajonin e Zall-Dajtit

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte testimi i kapaciteteve operacionale dhe të gatishmërisë së b2k të Forcës Tokësore, si repart prioritar i Forcave të Armatosura, vlerësimi i aftësive për planëzimin, organizimin dhe kryerjen operacionit në kushte sa më reale, si dhe koordinimi dhe bashkëveprimi me strukturat e tjera shtetërore në menaxhimin e emergjencave civile.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe komandanti Forcës Tokësore gjeneralmajor Zyber Dushku, ka inspektuar në datë 02 maj 2014, stërvitjen që zhvilloi Batalioni i Dytë i Këmbësisë (b2k) i Forcës Tokësore në rajonin e Zall-Dajtit. Ministrja Kodheli, pasi ka ndjekur nga afër stërvitjen dhe është takuar me trupat pjesëmarrëse, i ka falënderuar ato për arritjet gjatë zhvillimit të kësaj stërvitjeje ushtarake, “çka vërteton - nënvizoi ajo, - edhe një herë më së miri përgatitjen tuaj, gatishmërinë tuaj dhe besimin që ju keni tek puna që ju bëni.” “Ju jeni të denjë, - ka vijuar më tej znj. Kodheli, - për të përmbushur detyrën

tonë sa kushtetuese aq edhe fisnike të mbrojtjes së vendit, territorit të Shqipërisë, sigurinë e qytetarëve, të familjeve tona dhe padyshim edhe sigurinë jashtë kufijve të vendit.” Gjithashtu, ajo ka falënderuar të gjithë stafin drejtues dhe mbështetës për suksesin e arritur në këtë operacion stërvitor. “Unë uroj dhe shpresoj që edhe në të tjera stërvitje si kjo, ne do të vazhdojmë të dëshmojmë që jemi të denjë të mbrojmë divizën tonë dhe ta ngremë lart betimin tonë që kemi bërë përpara vendit, popullit dhe para vetes sonë”, është shprehur ministrja e Mbrojtjes Kodheli. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte testimi i kapaciteteve operacionale dhe të gatishmërisë së b2k të Forcës Tokësore, si repart prioritar i Forcave të Armatosura, vlerësimi i aftësive për planëzimin, organizimin dhe kryerjen operacionit në kushte sa më reale, si dhe koordinimi dhe bashkëveprimi me strukturat e tjera shtetërore në menaxhimin e emergjencave civile. Stërvitja e kërkim-shpëtimit u karakterizua nga një dinamikë e lartë dhe një larmi skenarësh, ku trupat e b2k u angazhuan në përballimin e situatave të emergjencave civile të shkaktuara nga kushtet e rënduara atmosferike. Në këtë stërvitje morën pjesë edhe dy helikopterë të Forcës Ajrore, si dhe forca e mjete të Policisë Ushtarake. Trupat





dhe mjetet ushtarake gjatë stërvitjes kanë kryer detyra për evakuimin e popullsisë së bllokuar, shpërndarjen e ndihmave ushqimore dhe dhënien e ndihmës së parë mjekësore. Ky ishte një operacion me kapacitete të FT-së, por i drejtuar nga Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO), duke u bazuar në parimet e task-forcës, gjeneruesit e forcës dhe përdoruesit e forcës. Nëpërmjet kësaj stërvitjeje u synua, testimi i kapaciteteve operacionale të b2k, të planëzimit, të mbështetjes me transport për lëvizjen e materialeve logjistike, të mbështetjes me ushqim të gatuar në natyrë në kushte fushimi, zbatimin e procedurave të vendimmarrjes së komandantit, shtabit dhe komandantëve të nënrepartëve për realizimin e misionit, si dhe zbatimin e procedurave standarde të komandim-kontrollit dhe integrimin e nënrepartëve të dhëna në komandim operacional. Në këtë stërvitje u demonstruan kapacitetet logjistike të b2k, për operacion kërkim-shpëtimi, ku më shumë u fokusua në mbështetjen shëndetësore për të plagosurit në bashkëpunim me Spitalin Ushtarak të FT-së. Gjithashtu u demonstruan edhe kapacitetet dhe mundësitë të mbështetjes me energji elektrike, ushqim, veshmbathje të komunitetit të prekur nga fatkeqësitë natyrore. Testimi nëpërmjet stërvitjes "Zall-Dajti 14", testoi kapacitetet e Forcës Tokësore, për përballimin e emergjencave civile, gjë që rezultoi e suksesshme.





“Kemi besimin e plotë që ju do ta kryeni me nder detyrën”

Ministrja Kodheli dhe SHSHP, bashkëbisedim me efektivat e kontingjenteve “MAT 5” dhe “Eagle 8”, në Afganistan

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, nëpërmjet një video konference, në datën 11 prill 2014, kanë bashkëbiseduar me efektivat e kontingjenteve “MAT 5” dhe “Eagle 8”, të cilët shërbejnë në kuadër të Aleancës, në operacionin ISAF në Kandahar dhe Kabul, Afganistan. Komandanti i “MAT 5”, kolonel Ardjan Bali dhe komandanti i “Eagle 8”, major Agron Kuta informuan ministren e Mbrojtjes Kodheli mbi situatën aktuale në teatrin e operacionit, si dhe me detyrat që paqeruajtësit tanë po kryejnë me sukses në Afganistan. Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, u është drejtuar efektivave të FA në Kabul dhe Kandahar: “Përhëndetje major Kuta i “Eagle 8”! Më vjen mirë që ju shikoj mirë. Është një gjë, kur e dëgjoj dhe marr informacionin nga

shkresat dhe, është një gjë tjetër kur ju shikoj. Jam shumë e kënaqur, madje e prekur nga raportimi që ju bëni, sepse shikoj dhe ndiej një realitet tjetër nga ai çka njerëz dashakeqës duan të krijojnë idenë e të përfitojnë nga sakrificat tuaja. Unë jam këtu garanti i sakrificës tuaj dhe garanti se dashakeqësit mos përfitojnë nga kjo gjë. Unë ju siguroj që në karrierën tuaj ushtarake, profesionale, pse jo dhe në eksperiencën tuaj jetësore, keni njohur shumë persona. Ka shumë mundësi që me asnjërin prej jush nuk njihem, por betohem në nderin tim që nuk do të keni asnjë mbështetës si Mimi Kodheli, ministër i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, sot dhe deri sa të vazhdojë jeta juaj, kudo që të jeni nën divizë apo jashtë divizës dhe këtë unë nuk e them për t'u përбетuar para jush. Unë këtë e kam vërtetuar sa herë që kam pasur në dorë përgjegjësi

të mëdha: jetën e njerëzve në gjithë dimensionet e saj dhe, nuk do të lë askënd që mund të vërë një ndarëse fiktive, të pandershme, të padrejtë midis të gjithë njerëzve në divizë, duke filluar nga shefi i Shtabit dhe deri tek ushtari më i fundit profesionist dhe meje. Fati i mirë e ka sjellë që unë të jem edhe grua, të kem sensibilitetin e një nëne edhe të një gruaje, madje edhe të një vajze. Fati e ka sjellë që unë të jem me profesion financiere, pra të kuptoj dhe nga taksimi shumë më tepër nga taksimi me të cilin mundohen të abuzojnë ata që nga taksimi nuk marrin vesh. Jam informuar dhe që kanë kaluar pagesat tuaja të zakonshme, në një kohë ashtu siç edhe shefi i Shtabit e tha përpara sesa unë t'ia bëja prezent kryeministrit çështjen e taksimit tuaj. Këtë gjë e ka bërë me shumë dinjitet, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, shumë kohë më përpara, kur ka diskutuar me shumë seriozitet me stafin juridik për të gjetur mënyrën që ju të përjashtoheni nga ky taksim. Besoj që do t'ia mbërrijmë, por ajo që besoj më fort është kjo gjë: ju jeni aty sepse keni bërë një betim; ju jeni aty sepse besoni tek atdheu edhe tek detyra juaj fisnike dhe kjo është shumë më e rëndësishme se sa çdo diskutim tjetër. Unë jam këtu jo sepse besoj tek rroga e ministrit, por sepse besoj akoma tek shërbimi ndaj atdheut, pra në një sens, megjithëse në role të ndryshme, jemi betuar njësoj: unë mbi kushtetutë e ju mbi flamur që do t'i shërbejmë vendit, patjetër duke i shërbyer edhe familjeve tona që është gjëja më e rëndësishme që kemi. Kështu që me urimin që morali juaj është po aq i lartë sa kjo që perceptojmë ne sot, unë, shefi i Shtabit, gjeneralët, të gjithë këtu, komandant Hoxha e të gjithë me radhë të vazhdojmë të jemi në unitet të plotë me njëri-tjetrin me shkëmbime informacioni dhe problemesh me njëri-tjetrin, me shpresën e madhe dhe besimin e plotë që ju do të vazhdoni ta kryeni me nder detyrën që ju është ngarkuar. Dhe fjala nder është një fjalë shumë e lartë, ndaj ju falënderoj për gjithë punën dhe mundin që keni bërë. Falënderoj gjithashtu edhe gjithë Shtabin e Përgjithshëm dhe gjithë ata që bëjnë të mundur që ju atje të jeni mirë me shëndet, me pagesat, me mbështetje të plotë nga ana e partnerëve tanë strategjikë, në mënyrë që asgjë të mos ju mungojë. Sigurisht që këtë radhë nuk ju ka munguar as fati, flas për "Eagle 8" në këtë rast, se duhet edhe pak fat në atë gjë që ju bëni". Një mesazh të veçantë u përcolli paqeruajtësve shqiptarë në Afganistan edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. "Ju falënderoj për performancën, disiplinën dhe frymën e bashkëpunimit, si ndërmjet jush, ashtu edhe me kolegët me të cilët ndani detyrat dhe përgjegjësitë. Shpreh bindjen se ju do të vazhdoni traditën e mirë të misioneve paqeruajtëse, duke lartësuar edhe më tepër vlerat kombëtare dhe të Forcave tona të Armatosura", u është drejtuar gjeneral Bazo efektivave të FA në Kabul dhe Kandahar.



Zhvillohet konferenca "5 vjet në NATO"

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datën 15 prill 2014, ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare "5 vjet anëtarësim në NATO: Impakti kombëtar-rajonale dhe sfidat e ardhshme". Kjo konferencë u organizua nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare. Ishin të pranishëm gjithashtu: ambasadori SHBA në Tiranë, z. Alexander Arvizu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, kryetari i Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha, diplomatë, studiues, përfaqësues të botës akademike, si dhe mjaft të ftuar të tjerë. Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, duke marrë fjalën ka shprehur vlerësimin e saj për Institutin Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare për organizimin e kësaj konference, e cila, nënvizoi ajo, vjen në vijim të një sërë veprimtarish të organizuara me rastin e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. "Nuk ka asnjë dyshim se anëtarësimi në NATO, ishte një arritje historike e Shqipërisë në rrugën e saj, duke lënë pas izolimin e gjatë dhe të imponuar. Vizioni ynë për ushtrinë do të mbështetet vetëm e vetëm, mbi kriteret profesionale dhe në integritetin moral. Ne do t'i kthejmë dinjitetin e munguar Forcave të Armatosura dhe nuk do të lejojmë që deklaratat për konsum dhe përfitim politik të dëmtojmë imazhin e ri që ne po krijojmë. Shqipëria dëshmoi se ishte një partner i besueshëm i Aleancës, duke ndërmarrë reforma në një spektër të gjerë që shkonin tej FA, të cilat padyshim janë shndërruar sot në urën e sigurtë që lidh Shqipërinë me NATO". Me këtë rast ministria Kodheli ka shprehur mirënjohjen e thellë të saj dhe të qeverisë për gjitha vendet mike dhe aleate të cilët kanë mbështetur që në hapat e para integrimin e Shqipërisë në NATO. Ndërsa ambasadori i SHBA, z. Alexander Arvizu në fjalën e tij u shpreh: "Sa i përket reformave të Mbrojtjes, Shtetet e Bashkuara të Amerikës vlerësojnë se përpjekjet e ministres Kodheli për kryerjen reformave dhe luftën kundër korrupsionit kanë të thella dhe rezultative. SHBA inkurajojnë vijmësinë e këtyre përpjekjeve. Në të njëjtën kohë pranojmë faktin se kontributi më afatgjatë në Reformën e Mbrojtjes është forcimi i themeleve të një force moderne, të lëvizshme dhe kompatibël me NATO. Kjo gjë kërkon metoda më të konsoliduara trajnimi, prokurimi dhe rekrutimi cilësor të personelit", - u shpreh ambasadori Arvizu.



Vëmendje dhe seriozitet për trajtimin e ushtarakëve me ushqim

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datën 18 prill 2014, bëri një vizitë në Komandën e Forcave Speciale në Zall-Herr. Znj. Kodheli dhe gjeneralmajor Jeronim Bazo u pritën nga komandanti i Batalionit të Forcave Speciale, nënkolonel Qazim Hoxha dhe ndoqën nga afër veprimtarinë ditore të efektivit të këtij batalioni të Forcave tona të Armatosura. Më pas të dy drejtuesit e lartë të FA, konsumuan së bashku me efektivin dhe drekën në mensën e repartit. Ministria e Mbrojtjes në buxhetin e vitit 2014 ka planifikuar edhe mbështetjen e nevojshme financiare për të gjithë kategoritë që përfitojnë ushqim. Autoritetet dhe specialistët përkatës të Ministrisë së Mbrojtjes kanë specifikuar kategoritë e ushtarakëve që përfitojnë në vijimësi ushqim të gatuar në njësi apo reparte. Aktualisht në FA trajtohen me ushqim të gjithë ushtarakët që kryejnë stërvitje të ndryshme si individuale, stërvitje shtabi, komplekse etj. Po kështu në njësitë dhe repartet ku është infrastruktura e ngritur përfitojnë ushqim të gjithë efektivat që kryejnë shërbime për ruajtje dhe gatishmërinë e njërive dhe reparteve ushtarake.

Ministrja Kodheli inspektoi ish-poligonin e demontimit të municioneve në Hajmel të Vaut të Dejës

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka inspektuar në datën 21 prill 2014, ish-poligonin e demontimit të municioneve në zonën e Hajmelit në Vaun e Dejës, i cili i është nënshtruar një rikontrolli dhe pastrimi nga trupa dhe mjete të Forcave të Armatosura. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, pasi u njoh nga afër me punën që po kryejnë efektivat e FA për pastrimin e këtij ish-poligoni, ka theksuar se procesi i demilitarizimit të hotspot-eve vijon në të gjithë vendin. Ky proces është shumë i rëndësishëm për jetën e qytetarëve tanë. Forcat e Armatosura janë në krye të kësaj veprimtarie shumë të rëndësishme për komunitetin, është shprehur ministrja Kodheli. Ndërsa gjeneralmajor Bazo, i ka kërkuar banorëve të kësaj zone që të qëndrojnë larg

ish-poligoneve të demontimit të municioneve. "Është e pamundur që të kontrollojmë të gjithë territoret, prandaj duhet edhe bashkëpunim me komunitetin e zonës", ka theksuar ai. Gjatë këtij inspektimi ka qenë i pranishëm edhe kryetari i Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Gjon Marku. Ai ka falënderuar FA, të cilat i janë përgjigjur kërkesës së pushtetit vendor dhe janë angazhuar për pastrimin sa më të plotë të këtij territori me qëllim sigurimin e jetës së banorëve, pasi ka pasur disa raste që është vënë në rrezik jeta e tyre, madje dy vjet më parë ka humbur jetën një banorë i këtij fshati.

Zhvillohet seminari "Inteligjenca dhe Demokracia"

Filloi punimet në datën 28 prill 2014, në Ministrinë e Mbrojtjes, seminari me temë "Inteligjenca dhe Demokracia". Në hapjen e këtij seminari ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ambasadori i SHBA në Tiranë, z. Alexander Arvizu, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, Visho Ajazi Lika dhe përfaqësues të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes. Në fjalën e hapjes, ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli tha se mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e informacionit në përputhje me nevojat e qeverisë, është një mjet shumë i rëndësishëm, jo vetëm sa i takon sigurimit të informacionit adekuat dhe të saktë, por edhe analizës së shëndoshë dhe të besueshme. Sipas znj. Kodheli, "Kur flasim për 'shërbime të inteligjencës' ne menjëherë na shkon mendja tek 'sekreti'. Kështu që sfida kryesore që shfaqet, apo që kërkon zgjidhje, është si t'i orientojmë që shërbimet apo organizmat që merren me inteligjencën të respektojnë sistemin demokratik". Ndërsa ambasadori i SHBA në Tiranë, z. Alexander Arvizu gjatë fjalës së tij theksoi se roli i shërbimeve inteligjente dhe mbikëqyrja parlamentare janë një çështje mjaft delikate. Sipas z. Arvizu kurrë nuk duhet lejuar që informacione të klasifikuara të dalin në publik. Seminari "Inteligjenca dhe Demokracia" i organizuar nga Zyra e Bashkëpunimit Ushtarak (ODC) pranë Ministrisë së Mbrojtjes, e mbylli punën më datën 2 maj 2014. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin edhe profesor James J. Wirtz, dekan i Fakultetit të Studimeve Ndërkombëtare dhe njëkohësisht profesor në Departamentin e Çështjeve të Sigurisë Kombëtare, Scott Jasper, lektor në Shkollën Pasuniversitare të Detarisë, në Qendrën për Marrëdhënie Civile-Ushtarake, si dhe në Departamentin e Çështjeve të Sigurisë Kombëtare dhe Florina Cristiana Matei (Cris), lektore me një eksperiencë të gjatë në fushën e inteligjencës, demokracisë dhe marrëdhënieve civile-ushtarake. Ekipi i profesorëve vinte nga Center for Civil-Military Relations (CCMR), Naval Postgraduate School, Monterey, Kaliforni.

Nëshkruhet "Plani i Bashkëpunimit Shqipëri-Greqi, 2014" në fushën e Mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, priti në datën 28 prill 2014, në një takim të veçantë znj. Fotini Gjenimata, ministre plotësuese e Mbrojtjes e Republikës së Greqisë, e cila, në krye të një delegacioni, ndodhet në vendin tonë për një vizitë zyrtare. Gjatë takimit ministrja

Kodheli e njohu znj. Gjenimata dhe delegacionin grek me zhvillimet e fundit në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, si dhe me hapat e ndërmarrë nga qeveria shqiptare për plotësimin e reformave jetike për mbrojtjen. Nga ana e saj, ministrja plotësuese e Mbrojtjes së Greqisë, znj. Gjenimata, falënderoi ministren Kodheli për pritjen, si dhe shprehu vullnetin e qeverisë greke që marrëdhëniet mes dy vendeve të vazhdojnë të jenë të shkëlqyera në fushën e Mbrojtjes, si dy vende partnere në rajon dhe anëtare të NATO. Ministria Gjenimata theksoi faktin se Shqipëria dhe Greqia kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë faktorë paqeje dhe stabiliteti për rajonin tonë. Dy bashkëbisedueset shprehën vullnetin për forcimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, si në atë të trajnimit dhe edukimit, sidomos për sektorë specifike të Mbrojtjes. Në fund të takimit mes dy delegacioneve u nënshkrua Plani i Bashkëpunimit Shqipëri-Greqi në fushën e Mbrojtjes për vitin 2014. Po në datë 28 prill, ministrja plotësuese e Mbrojtjes së Greqisë, znj. Gjenimata pati një takim edhe me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo.

Gjeneralmajor Bazo priti komandantin e Komandës së SEEBRIG gjeneral brigade Eser

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti në datën 29 prill 2014, në një takim të veçantë ekipin vlerësues të Komandës së SEEBRIG, të kryesuar nga komandanti i kësaj komande gjeneral brigade Hakan Eser. Gjeneral Bazo e njohu gjeneral Eser me zhvillimet e fundit të Forcave të Armatosura shqiptare dhe me progresin e bërë gjatë këtyre viteve si vend anëtar i Aleancës Euroatlantike. "Përmbushja e objektivave të kapaciteteve të NATO është përkushtimi ynë kryesor, sidomos në drejtim të reparteve të deklaruara në NATO", është shprehur ndër të tjera gjeneral Bazo. Të dy ushtarakët madhorë vunë theksin tek intensifikimi i stërvitjeve dhe rritjes së nivelit të operacionalitetit të reparteve sipas CREVAL



të njërive të deklaruara. Para takimit në fjalë, gjeneral brigade Hakan Eser dhe ekipi që ai kryeson, është takuar me zëvendësministren e Mbrojtjes, z. Dritan Hila. Qëllimi i vizitës disa ditore të ekipit vlerësues të Komandës së SEEBRIG në vendin tonë është inspektimi i nënreparteve të deklaruara nga FARSH, pjesë e kësaj strukture.

Gjeneralmajor Bazo, në 70-vjetorin e krijimit të Brigadës së VIII Sulmuese

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo mori pjesë në aktivitetin e organizuar në datë 23 prill 2014, nga Shoqata Kombëtare e Invalidëve të LANÇ të popullit shqiptar, me rastin e 70-vjetorit të krijimit të Brigadës së VIII Sulmuese. Në këtë aktivitet merrnin pjesë gjithashtu veteranë, ish partizanë të Brigadës së VIII Sulmuese, përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, familjarë të dëshmorëve të kësaj brigade, etj. Gjeneral Bazo shprehu kënaqësinë e veçantë të pjesëmarrjes në këtë ditëlindje të 70-të të një prej formacioneve më të rëndësishme ushtarake të Luftës Nacionalçlirimtare, atë të Brigadës së VIII Sulmuese. "Partizanët e Brigadës së VIII-të Sulmuese, bij të thjeshtë të trevave atdhetare dhe patriotike të jugut, shkruan me gjakun e tyre histori lavdie gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Emrat e dëshmorëve të kësaj brigade, të shokëve dhe shoqeve tuaj të armëve, të cilët dhanë jetën për atdheun në moshën më të bukur, janë shkruar me shkronja të arta në panteonin e kombit shqiptar. Ne jemi krenarë për gjakun, mundin dhe sakrificat tuaja! Në këtë ditë të shënuar për ju dhe për historinë e popullit shqiptar, shpreh bindjen dhe besimin tim të palëkundur se ëndrrat, idealet dhe gjaku i 28 mijë dëshmorëve do të respektohen ndër breza", ka vlerësuar ndër të tjera në fjalën e tij SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Brigada e VIII-të Sulmuese u formua në 25 prill të vitit 1944, në Sheper të Zagorisë. Ajo ka qenë një nga formacionet më të mëdha e më të shquara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare. Kjo brigadë ka luftuar për çlirimin e qyteteve të Gjirokastrës, Beratit, Lushnjës dhe Tiranës, si dhe jashtë kufijve administrativë shqiptarë, duke dhënë një kontribut të madh edhe në çlirimin e viseve kosovare.

Aleatët, vlerësime qeverisë për ristrukturimin e FA-së

Fjala e ministres së Mbrojtjes Kodheli, në Kuvendin e Shqipërisë, në datë 17 prill 2014

Prej një jave mediat janë bërë pasqyrë e një shpërthimi ekstrem të politikës së baltës për të errësuar imazhin rilindas të FA. Ka një javë që opozita ngre në pikëpyetje, duke lënë të kuptojë se është në dijeni të një të vërtete të tmerrshme, por pa thënë asgjë tjetër përveçse që unë, si ministre e Mbrojtjes, po e fsheh këtë informacion dhe nuk po bëj transparencë. Më e bukura siç i thonë, por në fakt më e trishtueshmja në këtë rast, është se ndërkohë që disa zotërinj aspak qelibar, pushtojnë ekranet me këtë lloj cinizmi dhe s'dëgjohet asnjë gazetar që të pyesë. Po mirë të akuzuarit dhe qeveria nuk japin shpjegime, po akuzuesit çfarë provash kanë? Do thoni ju zotërinj opozitarë të angazhuar në këtë përbaltje të ethshme, po pse duhet të na pyesë media ne dhe të mos na jepni ju llogari për akuzën tonë tronditëse? Është shumë e thjeshtë, sepse unë kam një detyrë, të bëj punën aspak komode të ministres së Mbrojtjes, duke u marrë nga mëngjesi herët deri në darkë vonë me problemet e panumërta dhe për ju, për opozitën, për pyetjet, për pretendimet e saj, kam vetëm një ditë në javë, këtë ditë, ditën që vij në Parlament. Ndërsa ju, keni përditë detyrën që çdo akuzues ka në sistemin demokratik që keni zgjedhur, ta provojë akuzën e tij duke, së paku, bërë përpjekje që të provojë vetë akuzën. Sepse në demokraci barra e provës i takon atij që akuzon dhe jo atij që akuzohet. Por jo, me kë e keni, ju thjesht dhe vetëm akuzoni, pa dhënë asnjë provë, pa thënë asgjë më pak sesa infrastruktura e ushtrisë shqiptare është vënë në shërbim të trafikut të drogës dhe, asgjë më shumë se Shqipëria është bërë protektorat i drogës. Turp i madh. Sa qesharake aq edhe cinike kjo lojë. Por edhe sa e papërgjegjshme në raport me FA e këtij vendi dhe me vetë këtë vend, ku bëhet gjithë ky sforcim për të prodhuar gjithë këtë baltë. Ju zotërinj, nuk keni asnjë provë mesa duket, por ajo çka unë mund t'ju them sot, është kjo: nuk ka asnjë provë të vetme dhe fakt të vërtetuar që Forcat e Armatosura, apo bazat e ushtrisë shqiptare janë të implikuara në veprime kriminale për të cilat është folur kaq shumë këtë javë dhe për të cilat ju FA-të i keni akuzuar. Dhe



nuk keni akuzuar vetëm FA-të por gjithë këtë vend. Nuk ka asnjë provë dhe asnjë fakt, zero. Me përgjegjësinë time institucionale, si ministre e Mbrojtjes dhe si politikane, si përfaqësuese e popullit në këtë Kuvend, po jua përsëris qartë. Qysh prej gjysmës së shtatorit të vitit 2013 e deri më sot, gjatë gjithë kësaj kohe që kjo qeveri ka marrë këtë detyrë, nuk ka rezultuar në asnjë rast dhe në asnjë zonë ushtarake të RSH, të ketë një të dhënë të vetme të verifikuar ku ka lindur në fakt zanafilla e gjithë kësaj balte dhe tymnaje, e gjithë kësaj patologjie opozitare lidhur me FA. Nëse shqetësimi juaj buron, prej çka mund të ketë ndodhur përpara shtatorit të vitit 2013, pra në mars apo në shtator-tetor të një viti më përpara kur ju qeverisnit, kjo është një çështje tjetër për të cilën mbase duhet të na japë përgjigje ndonjë organ hetimi, por as unë, as Ministria e Mbrojtjes sot. Mund t'ju them gjithashtu se qysh prej shtatorit të vitit 2013 nuk ka asnjë shërbim partner që të ketë bërë me dije Ministrinë e Mbrojtjes, apo organet e specializuara, të një prove të vetme, apo qoftë të një

dysimi për veprimtari ekstremisht kriminale, për të cilën ju keni një javë që drejtoni gishtin nga FA. Dhe ju e dini mirë, se ky vend është vend i NATO-s dhe, shërbimet partnere kanë marrë vesh, për shembull fjala që bie, deri edhe se sa para janë kërkuar e paguar nën dorë për listat e misionëve të djemve që shkonin në Afganistan. Apo për shembull sa herë kanë udhëtuar të dërguarit e ish-ministrit diku jashtë për të marrë në rrugë të paligjshme mjetet e përgjimit të opozitës. Apo në cilën mënyrë janë zëvendësuar hard-disqet e aparaturës së fjalë. Prandaj zotërinj, merrni me qetësi, siç këshillon shpesh kryetari i Kuvendit, këtë rrugën tuaj të re opozitare dhe mos e zhvillonin shumë fantazinë tuaj deri në këto nivele marramendëse për të çoroditur publikun, pa dashur të dini se në këtë mënyrë nuk baltosni qeverinë, por Shqipërinë. Sa për Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat drejtuese ushtarake, ne jemi plotësisht të angazhuar që t'i kthejmë sektorit, dinjitetin e rrënuar, të zhdukim praktikat korruptive, t'i japim Shqipërisë vendin që i takon, jo vetëm fizikisht por moralisht dhe profesionalisht në tryezën e NATO. Në atë tryezë ku më vjen keq të them, e kishit vënë në pozitë shumë të vështirë Shqipërinë me bëmat dhe gjëmat tuaja, që aq mirë i dinë të gjithë, më mirë se ne, partnerët tanë ushtarakë. Unë e siguroj Kuvendin e Shqipërisë dhe opinionin publik se FA, strukturat e saj të sigurisë, komandat, deri tek ushtarët e thjeshtë, kanë kryer tashmë të gjitha procedurat e nevojshme, duke i dhënë tashmë një rëndësi të veçantë procedurave të ruajtjes, përdorimit, shfrytëzimit dhe menaxhimit të çdo të dhëne sado e parëndësishme që është, me qëllim rritjen e sigurisë, disiplinës dhe garantimin e trajtimit profesional të gjithë volumit të informacionit që përpunohet në sektorët tanë, përballë kërcënimeve dhe rreziqeve të një bote përditë e më të sofistikuar e më agresive. Unë e shpreh sigurinë, jo vetëm në përgjegjësinë time të lartë, por edhe në cilësi të plotë që më jep fakti që këtë siguri e mbështes jo thjesht tek të dhënat tona, por padyshim te informacioni i plotë që shkëmbej rregullisht me partnerët tanë të cilët, pas jo pak ditësh të humbura, kanë rifituar besimin e plotë tek ekipi drejtues politik dhe ushtarak i dikasterit të Mbrojtjes; siç e kanë rifituar qetësinë e humbur deri dje prej shpërdorimit dhe abuzimit të çdo lloji që ata e konstatojnë, për fat të keq pothuajse përditë. Detyra dhe natyra shumë specifike e punës që kam nderin të bëj, e kufizon mundësinë time për t'i larë sot "hesapet politike" në këtë sallë dhe, për t'ia thënë në sy, ndokujt këtu e ndokujt jashtë këtyre mureve, të gjitha të vërtetat e mia si politikane për shpifjet e turpshme të kësaj jave. Por prapëseprapë nuk është e vështirë të kuptohet nga të gjithë ajo, që është fare e qartë për mua dhe për qeverinë. Vala e ngritur me akuza gjatë javës së fundit ka lidhje me nevojën therëse që kanë qoftë paraardhësi im, qoftë paraardhësi i kryeministrit tim për të penguar me çdo kusht dritën e ligjit mbi errësinën e paligjshmërisë shokuese të dosjeve të

Më së shumti, vlerësohet përpjekja për vendosjen në vend të dinjitetit të ushtrisë shqiptare, si një ndër sfidat më shpresëdhënëse të dekadës së fundit në rajon.

shpërdorimit të detyrës sa herë që flasim për ushtrinë. Uroj shumë të mos e ketë zënë gjumi në këtë rast edhe Prokurorinë e Përgjithshme mbi këto dosje, sidomos në tre prej tyre, që lidhen drejtpërdrejtë me raportin që ka pasur dhe duhet të ketë, kur flitet për sigurinë kombëtare. Ashtu sikundër, e garantoj popullin shqiptar se nuk është thjesht qeveria e Shqipërisë e interesuar që kultura e pandëshkueshmërisë në drejtimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FA të marrë fund përmes hetimit dhe nxjerrjes së fajtorëve për rrënimin moral, profesional dhe financiar të ushtrisë në vitet e fundit të keq-qeverisjes së opozitës së sotme. Jo më kot, qysh

në ditët e para që akuza skandaloze u artikuloi në një formë gjysmë të dehur nga ai që në fakt duhet të mbulohej prej kohësh përballë prokurorëve, unë i jam drejtuar prokurorit të Përgjithshëm që ta hetojë sa më parë këtë akuzë. Jo më kot e kam përsëritur me shkrim kërkesën time ndaj z. Llalla dhe dua ta përsëris edhe sot: kjo akuzë duhet të hetohet në mënyrë të pavarur, pavarësisht se s'ka asnjë lloj prove për të, sepse në këtë lojë të shpifur politike nuk mjafton të hetohet vetëm akuzat, por duhet hetuar edhe pse është hapur kjo lojë, nëse të gjithë themi dhe duhet të themi që ishte një gënjeshtëri. Por dua të shtoj që përtej kërkesave për të hetuar ish-ministrin e Mbrojtjes dhe kupolën në dikasterin tonë, si dhe kërkesës për hetim

që kemi depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me akuzën e përsëritur pa pushim këtë javë, ne kemi bërë dhe shumë punë të mira. Punë që ne i kemi bërë në pak muaj, ndërkohë që ju nuk mundët apo nuk deshët që t'i bëni sidomos në këto vitet e fundit. Fjala vjen, ne hodhëm dritë mbi bregdetin tonë që ju e kishit lënë dy vjet e ca në errësinë. Përsa ju takon gjatë kësaj periudhe që keni qeverisur, nuk keni dalë akoma të thoni se çfarë ka ndodhur gjatë kohës që ishte errësinë në det. Si dhe pse ky vend i NATO, ndenji dy vjet e ca me radarë të prishur? Diçka kemi mundur të marrim vesh, vetëm e vetëm se kemi parë se çfarë shkruhet për Shqipërinë e errësirës suaj në vlerësimet e organizmave të specializuara të sigurisë dhe në analizat e shteteve aleate. Dhe meqenëse jemi te aleatët, më lejoni për këtë herë mungesën e modestisë, sepse dua t'ju përcjell literalisht një vlerësim të tyre në njërin prej takimeve më të rëndësishme multilaterale: "Ne vlerësojmë punën e filluar prej qeverisë suaj lidhur me ristrukturimin dhe rritjen e profesionalizmit të FA, por më së shumti me vendosjen në vend të dinjitetit të ushtrisë shqiptare, si një ndër sfidat më shpresëdhënëse të dekadës së fundit në rajon." E pra, merrni me qetësi se pavarësisht çdo lloj përpjekjeje për të hequr vëmendjen nga mëkatet tuaja në qeveri, apo për të na penguar ne që të qeverisim, karvani ynë i gjatë do të shkojë vetëm përpara. Lërinin djemtë dhe vajzat e thjeshtë nën uniformë të bëjnë detyrën e tyre fisnike. Unë kaq kisha, tani ju bëni ç'të doni dhe shpifni sa të doni, deri të enjten tjetër nuk kam asnjë minutë për t'u marrë me diskutime pa bereqet.

STRATEGJIA



Interesat kombëtare, siguria kombëtare dhe marrëdhëniet mes tyre

EVEREST HAXHI

M

arrëdhëniet midis interesave kombëtare dhe sigurisë kombëtare janë shumë të rëndësishme në kohën ku jetojmë. Shtetet gjithnjë e më tepër i drejtojnë politikat e brendshme dhe të jashtme në varësi të dinamikës së ndërthurjes së këtyre dy elementëve. Më shumë se tre dekada më parë, Henry Kissinger në artikullin e tij "Politika e Jashtme e Amerikës; Tre esetë" shtroi disa nga pyetjet më thelbësore për raportin midis interesave kombëtare dhe sigurisë ku qartë shprehu dilemën se "Çfarë është në interesin tonë kombëtar për të parandaluar? Çfarë duhet të bëjmë për ta realizuar? . Të njëjtat pyetje vazhdojnë të sfidojnë hartuesit e politikave, studiues, dhe zyrtarë të lartë të institucioneve të rëndësishme vendimmarrëse të të gjitha vendeve. Në raport më këtë dinamike zhvillimi midis interesave kombëtare dhe sigurisë, rajoni dhe vendi ynë nuk mund të bëjnë përjashtim. Reflektimi i parë se si Shqipëria duhet të mendojë për realizimin e interesave kombëtare dhe çfarë duhet të parandalojë në raport me këto interesa vendos natyrshëm një dimension rajonal ndërthurur më dimensionin e brendshëm dhe rolin që secili nga këto dimensione merr në situata të caktuara politike. Fakt është që sot vendet e rajoni dhe fqinjët tanë operojnë maksimalisht sipas këtyre referencave duke lënë herë pas here vendin tonë vulnerabël dhe me alternativa të cunguara zgjidhjeje. Duke iu referuar kësaj

përjasje dhe deklarata e Ministrit të Jashtëm Grek Venizelos për njohjen e Kosovës ruante këtë linjë mendimi duke deklaruar se Greqia nuk ka asnjë problem për njohjen e Kosovës por vendimet merren vetëm në përputhje me interesat kombëtare të Greqisë. Pra është e qartë që secili vend operon me interesa prioritare të sigurisë së vet kombëtare dhe përjasja rajonale është vetëm në mbështetje të tyre pavarësisht nëse dimensionin rajonal mund të shërbejë si burim rreziku për interesat kombëtare të secilit prej vendeve që përbëjnë rajonin. Në kohën ku jetojmë çështjet që lidhen me sigurinë dhe rolin që duhet të luajnë aktorët shtetërorë për të ofruar siguri maksimale po bëhen gjithnjë e më të komplikuar. Në vendin tonë komplikimi lidhet edhe me aspektin perceptual të sigurisë dhe pyetja shtrohet se “A dinë shqiptarët se çfarë apo cilat janë interesat kombëtare të vendit tonë?” Në shikim të parë pyetja duket relativisht e thjeshtë duke u përgjigjur po thjeshtë se:

“Interesat kombëtare të Shqipërisë janë ato të promovimit të vlerave dhe objektivave të vendit duke qartësuar që promovimi kuptohet si mbrojtje e vlerave dhe objektivave të Shqipërisë duke përdorur strategji efikase dhe politika të suksesshme të sigurisë kombëtare.”

Po të bëjmë një analizë më të hollësishme kuptojmë se përgjigja e mësipërme është jo e përshtatshme pasi në raport me dinamikën e zhvillimit të vendit pyetjet që dalin janë:

1. Cilat janë vlerat tona?
2. Si janë ato të reflektuara në interesat kombëtare?
3. Cila është lidhja midis interesave kombëtare dhe sigurisë kombëtare?
4. Si mund të implementohen politikat e sigurisë kombëtare në mënyrë që të kenë impaktin dhe benefitet maksimale për vendin tonë brenda dhe jashtë vendit?

Këto pyetje duhet të jenë baza për adresimin e vakumit në të cilin gjendet vendi ynë në raport me interesat kombëtare dhe sigurinë kombëtare për një përjasje analitike dhe me analiza të kujdesshme të



PROMOVIMI

Interesat kombëtare të Shqipërisë janë ato të promovimit të vlerave më të larta kombëtare të vendit jo vetëm në teatrin e brendshëm por edhe në arenën ndërkombëtare.

këtij problemi kaq delikat.

Një gjë është pothuajse e sigurt që të gjitha brezat në vendin tonë kanë kërkuar dhe kërkojnë të bëjnë interpretimin e tyre se cilat janë vlerat tona që na karakterizojnë dhe na dallojnë nga vendet e tjera të rajonit. Po ashtu në të njëjtën shkollë mendimi politik dhe shoqëror të gjitha brezat kërkojnë të bëjnë interpretimin e tyre për interesat kombëtare dhe cilat duhet të jenë politikat efektive të sigurisë kombëtare mbështetur kjo në këndvështrimin e tyre dhe specifikat politiko-shoqërore të secilit brez. Edhe pse ka një emërues të përbashkët, ai i mbrojtjes së atdheut, brezat diferencojnë njëri tjetrin në mënyrat e përcaktimit të sigurisë

kombëtare, nga mënyra e perceptimit të rrezikut të jashtëm apo të brendshëm dhe nga rrugët që mund të ndiqen në implementimin e drejtë të politikave të sigurisë kombëtare. Mendoj se është e natyrshme që për një vend si yni dhe me specifikat rajonale të njohura tashmë është e pritshme që të kemi interpretime të ndryshme mbi atë çfarë konsiderohet një politikë e suksesshme në mbrojtje të interesave kombëtare. Për këtë, eksplorimi i koncepteve të sigurisë kombëtare, vlerave kombëtare dhe interesave kombëtare duhet të jetë pjesë e qenësishme e procesit të analizës dhe formatimit të politikave efektive të sigurisë kombëtare në interes të promovimit dhe mbrojtjes së vlerave dhe objektivave kombëtare.

Interesat Kombëtare

Interesat kombëtare të Shqipërisë janë ato të promovimit të vlerave më të larta kombëtare të vendit jo vetëm në teatrin e brendshëm por edhe në arenën ndërkombëtare. Ndjekja e këtyre interesave kërkon përpjekje maksimale për krijimin e një klime të favorshme brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që të realizohet nxjerrja në pah e këtyre vlerave. Promovimi lehtësohet kur vlerat kombëtare kanë specifika të tilla që bëhen modele suksesi edhe për vendet e tjera siç është shembulli i njërës prej vlerave më të spikatura dhe unike të popullit tonë ajo e bashkëjetesës dhe harmonisë fetare. Vlerat kombëtare promovojnë harmoninë brenda vendit dhe janë baza kryesore në ndërtimin e raporteve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë, në promovimin dhe mbrojtjen e interesave kombëtare. Edhe pse në shekullin ku jetojmë faktori i brendshëm ka marrë një rol primar si rezultat i thyerjes së koncepteve klasike të mbrojtjes dhe rreziqeve asimetrike të cilat përmbledhin krimin e organizuar, terrorizmin dhe specifikat rajonale të konflikteve etnike duhet që të kemi parasysh tre gjëra kryesore:

1. Projektimi i vlerave kombëtare të vendit tonë në rajon dhe në botë duhet të jetë themeli mbi të cilin duhet të formatohen interesat

të ndryshme të sigurisë si dimension i politikave të sigurisë dhe ai i prioriteteve. Vende të ndryshme të botës në përputhje me specifikat kombëtare janë munduar të përcaktojnë principet themelore mbi të cilat duhet të bazohet studimi i sigurisë kombëtare. Në këtë fushë shkolla amerikane e mendimit të politikave të sigurisë prevalon duke përcaktuar tre përfaqeset kryesore në studimin e sigurisë kombëtare. Mendoj se kjo përfaqesje duke i shtuar specifikat kombëtare të vendit tonë mund të shërbejë si fillim i mbarë në kuptimin e drejtë të termit "Siguri Kombëtare" dhe rolit që luajnë vendimmarrja, shoqëria dhe institucionet në një vend demokratik. Për këtë duke iu referuar gjithmonë shkollës amerikane kemi këto tre përfaqesje kryesore për studimin e sigurisë kombëtare:

1. Përfaqesja koncentrike-rrethore vendos presidentin në qendër të procesit të hartimit të politikave të sigurisë kombëtare. Këshilltarët dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare ofron suport në vendimmarrje dhe krijojnë premisat për implementimin efikas të këtyre politikave. Kjo përfaqesje tregon qartë nivelin e rëndësisë së grupeve të interesit dhe aktorëve kryesorë që janë pjesë e procesit të hartimit të politikave të sigurisë. Nëse do të marrim një shembull dhe do të konsideronim në një moment të caktuar që objekt kryesor i sigurisë kombëtare do të ishte influencimi i fqinjëve tanë për rritjen e dialogut rajonal dhe konsolidimin e parimit të fqinjësisë së mirë, atëherë më afër qendrës do të ishin pikërisht fqinjët tanë si objekt i rëndësishëm i sigurisë kombëtare. Pavarësisht rëndësisë së jashtëzakonshme që ka Parlamenti, shoqëria dhe media në këtë proces ata nuk janë objekt i sigurisë kombëtare dhe pozicionimi i tyre në përfaqesjen koncentrike-rrethore do të ishte periferik.

2. Përfaqesja e pjesëmarrjes së elitave në politikë bazohehet në parimin bazë të shoqërisë demokratike, i cili përcakton që proceset politike dominohen nga elitat. Kjo përfaqesje vendos elitat si udhëheqëse të procesit të hartimit të politikave të sigurisë kombëtare



brenda kornizave institucionale të përcaktuara pavarësisht se grupet elitare të përfshira në proces duhet domosdoshmërisht të sigurojnë publikisht mbështetjen popullore për legjitimitimin e procesit. Kjo mbështetje duhet pasi edhe pse elitat kanë kapacitetin e duhur intelektual dhe akses të informacioni i klasifikuar që i ndihmon në hartimin e politikave efikase të sigurisë kombëtare, për të siguruar suksesin afatgjatë të këtyre politikave kërkohet një nivel i caktuar pjesëmarrjeje publike e mishëruar në hapësirat që klasa politike krijojnë për kontribute të tilla nga shoqëria. Përfaqesja e modelit elitare për sigurinë kombëtare përcakton Presidentin, Kryeministrin, Këshilltarin e Sigurisë Kombëtare, anëtarë të rëndësishëm të kabinetit qeveritar, anëtarë të parlamentit, ushtarakë të lartë dhe liderë të komunitetit të biznesit si pjesë e një rrethi të ngushtë që është hartues i politikave të sigurisë kombëtare. Ky model përfaqesja ka disavantazhin e mos balancimit të aftësisë dhe fuqisë së elitave me konceptin e demokracisë gjithëpërfshirëse.

3. Modeli i tretë i përfaqesjes është ai i analizës së sistemit. Ky model jep rëndësi dinamikave të marrëdhënieve midis aktorëve vendimmarrës në të gjitha hapat e procesit të hartimit të politikave të sigurisë kombëtare. Të gjitha imputet dhe indikacionet që vijnë

analizohen nga aktorët politikë vendimmarrës dhe nëpërmjet metodave krahasuese, vlerësuese të ambientit të sigurisë dhe prioriteteve të përcaktuara hartojnë një politikë të sigurisë kombëtare të pranueshme për pjesën dërrmuese të aktorëve dhe grupeve të interesit. Impakti që ka politika e hartuar në këtë mënyrë duhet të monitorohet vazhdimisht nga "feedback" për efikasitetin e saj dhe si perceptohet nga ata që e ndjejnë direkt atë.

Njohja e interesave kombëtare dhe analizat studimore mbi sigurinë janë të rëndësishme për të kuptuar qartë jo vetëm procesin e hartimit të politikave të sigurisë kombëtare por edhe për të kuptuar drejt rolin që kanë aktorët e ndryshëm pjesëmarrës në këtë proces. Në promovimin e vlerave dhe përcaktimin e objektivave si bazë të interesave kombëtare modelet perëndimore bëhen gjithnjë e më të qarta duke i shtuar atyre elementët specifikë të natyrës së mjedisit të sigurisë që rrethon rajonin dhe vendin tonë. Në këtë mënyrë mund të realizojmë një proces të suksesshëm hartimi të politikave të sigurisë dhe një përfaqesje të drejtë të rolit që duhet të luajë klasa politike, institucionet e sigurisë e të mbrojtjes, shoqëria dhe mediat pa cenuar parimet themelore të ruajtjes së balancave midis institucioneve vendimmarrëse dhe demokracisë gjithëpërfshirëse.



Ky artikull është i shtati i një serie artikujsh nga Ekipi Amerikan i Transformimit të Mbrojtjes (Cubic) mbi spektrin e koncepteve, parimeve, metodologjive dhe proceseve të integrimit të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO). Objektivi i këtyre artikujve është të krijojë një kuptim më të mirë të koncepteve, çështjeve parimore, kërkesave dhe problemeve thelbësore të këtij integrimi.



PHD Louis L. Boros

Parimet e menaxhimit të burimeve njerëzore: Një perspektivë amerikane

BURIMET NJERËZORE

↳ *Nga ana njerëzore (BNj) ushtarake është kryesisht i fokusuar në përmbushjen e nevojave për fuqi punëtore në ushtri. Duke bërë këtë, sistemi i BNj gjithashtu merr në konsideratë, me aq sa është e mundur, nevojat personale të ushtarakëve individualë.*

Objektivi themelor i Ekipit Këshillues Cubic është që të asistojë Shqipërinë në zhvillimin e "Ushtrisë më të mirë të vogël në NATO!" Kjo nuk ka të bëjë aspak me përmasën aktuale të forcave të armatosura dhe merr në konsideratë faktin që të gjitha Forcat e Armatosura ndryshojnë në strukturë dhe kapacitete me kalimin e kohës. Qëllimi ynë kryesor është që të ndihmojnë në zhvillimin e ushtrisë të udhëhequr dhe menaxhuar në mënyrën më profesionale dhe më të mirëorganizuar, të stërvitur, pajisur dhe operuar në Aleancë, një ushtri ku të gjitha burimet përdoren në

mënyrën më efektive dhe efikase të mundur. Kjo kërkon një diskutim të konsiderueshëm dhe formulimin e koncepteve të reja për sa i përket burimeve njerëzore të ushtrisë. Forcat e armatosura financohen nga taksat e grumbulluara nga qytetarët shqiptarë dhe rrjedhimisht duhet të punojnë për të menaxhuar burimet njerëzore dhe materiale në mënyrën më efektive dhe efikase të mundur.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Nga ana institucionale, menaxhimi i burimeve njerëzore (BNj) ushtarake është kryesisht i fokusuar në përmbushjen e nevojave për fuqi punëtore në ushtri. Duke bërë këtë, sistemi i BNj gjithashtu merr në konsideratë, me aq sa është e mundur, nevojat personale të ushtarakëve individualë. Megjithatë, është e rëndësishme të vihet në dukje që duke dalë vullnetar për t'u bërë pjesë e forcave të armatosura, ushtarakët bien dakord dhe kuptojnë që nevojat e ushtrisë si një institucion vijnë të parat. Menaxhimi i BNj është një proces tejet kompleks i cili kërkon disiplinë intelektuale dhe procedurale në përcaktimin dhe aplikimin e parimeve, koncepteve dhe procedurave standarde të operimit të menaxhimit të njerëzve për të mundësuar menaxhimin e forcave të armatosura. Sistemi ushtarak i menaxhimit të BNj kërkon ligje të qarta dhe jo të dykuptimta, rregullore dhe standarde të përkufizuara qartë, dhe procedura standarde të operimit (PSO). Elementet kompleksë të sistemit të BNj ndërthuren dhe duhet të merren në konsideratë dhe administrohen në tërësi.

Shikoni Figurën 1 më poshtë.




Figura 1. Shtrirja e menaxhimit të burimeve njerëzore ushtarake

Proceset e menaxhimit të njerëzve në ushtri përfshijnë dy fusha kryesore: Menaxhimin e Fuqisë Punëtore (shpërndarja e personelit në të gjithë forcat e armatosura), dhe Menaxhimin e Personelit (menaxhimin e ushtarakëve individualë). Këto dy procese janë ngushtësisht të lidhura me njëra tjetrën.

Menaxhimi i Fuqisë Punëtore: Mjetet e kontrollit për

përdorimin më efikas dhe ekonomik të të gjithë personelit të disponueshëm në arritjen e misioneve dhe detyrave të përcaktuara të institucionit. --- Fjalori Military and Associated Terms. (Përkufizimi i modifikuar). US Department of Defense, 2005.

Menaxhimi i Personelit: Sistemi i planifikimit, organizimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe ekzekutimit të procedurave efektive për menaxhimin e ciklit jetësor të karrierës së individëve të forcave të armatosura, përfshirë rekrutimin, stërvitjen dhe arsimimin, shpërndarjen, dislokimin, vetëmbështetjen, zhvillimin profesional, avancimin e karrierës dhe largimin nga forcat e armatosura. --- U.S. Army Regulations 800-6 (Përkufizimi i modifikuar)

Parime dhe Koncepte të Menaxhimit të Fuqisë Punëtore

Parlamenti shqiptar çdo vit përcakton dhe autorizon numrin e përgjithshëm (dhe buxhetin) e forcave të armatosura. Bazuar në atë autorizim, i gjithë komuniteti i mbrojtjes (drejtuesit civilë të ministrisë dhe forcat ushtarake), përfshirë të gjitha strukturat/njësitë e mbrojtjes, përcaktohen në Tabelën e Organizimit dhe Pajisjeve (TOP) duke përdorur programet e automatizuara të menaxhimit. TOP është një dokument kyç dhe themeltar që specifikon misionet dhe detyrat e secilës njësi si dhe hierarkinë e brendshme strukturore dhe të gradave (ndarjet dhe marrëdhëniet e brendshme organizative), dhe aftësitë ushtarake dhe të tjera (specialitete të ushtarakut) dhe kualifikime

(arsimimi, njohjet gjuhësore, kurset, etj.) që kërkohen nga secili person i emëruar në secilin pozicion individual në TOP.

TOP specifikon kërkesat dhe standardet për personin e duhur, me aftësitë dhe kualifikimet e duhura, të emëruar në punën e duhur, në kohën e duhur, për secilin pozicion brenda forcave të armatosura. Përmbushja e kërkesës është objektivi kryesor i menaxhimit të BNj. Aktualisht, Forcat e Armatosura të Shqipërisë ende nuk e përmbushin këtë kërkesë. Praktika aktuale e shpeshtë që i kërkohet anëtarëve individualë të FARSH të gjejnë vetë punën e tyre, është shkatërruese ndaj efikasitetit dhe kapaciteteve të një organizate e cila mund

të thirret në betejë, një praktikë e cila nuk duhet të lejohet të vazhdojë! Sistemi i menaxhimit të fuqisë njerëzore duhet të përzgjedhë individët në mënyrë konkurruese bazuar në aftësitë dhe meritën, dhe t'i dërgojë në trajnime dhe arsimim të avancuar dhe t'i përgatisë për të përmbushur nevojat njerëzore të forcave të armatosura. Kur një njësi apo një strukturë



i ka të gjitha pozicionet të plotësuara, dhe të gjithë individët i kanë të gjitha aftësitë dhe kapacitetet e kërkuara ashtu sikundër janë të përkufizuara në TOP, njësi/struktura operon në një nivel gatishmërie të personelit prej 100%. (Gatishmëria e personelit është vetëm një nga elementët e gatishmërisë së përgjithshme të njësisë). Megjithatë, përderisa asnjë forcë ushtarake, kudo që të jetë, nuk i ka të gjitha burimet njerëzore apo materiale që i nevojiten, objektivat kyç të menaxhimit të fuqisë njerëzore janë:

- Për të identifikuar kërkesa të së ardhmes të fuqisë njerëzore dhe për të përcaktuar se çfarë përgatitjeje, trajnimi dhe arsimimi nevojitet për të mbushur vendet bosh që do të krijohen në forcat e armatosura, dhe

- Në mënyrë aktive të identifikojnë, përzgjedhin dhe dërgojnë individët në kurse të përshtatshme të aftësive dhe përgatitjes ushtarake si dhe arsimit të avancuar në kohë për t'i përgatitur për emërimet e ardhshme.

- Të emërojnë individët me kualifikimet e duhura në pozicionet vakante, bazuar në nevojat e forcave të armatosura dhe shpërndarjen me kosto më efektive dhe efikase të burimeve të disponueshme njerëzore.

Analizë e Fuqisë Njerëzore

Raportet mujore të gatishmërisë të përgatitura nga komandantët/drejtorët e njësisë dhe institucioneve duhet të reflektojnë me kujdes nëse njerëzit e duhur, me aftësitë e duhura janë në punët e duhura në atë njësi/institucion.

Raporti i gatishmërisë duhet të parashikojë para në kohë për të treguar vendet vakante që do të krijohen si rezultat i transferimit apo daljes në pension të personelit të emëruar në ato pozicione. (Raportet gjithashtu duhet të reflektojnë statusin e pajisjeve dhe materialeve të njësisë në një

mënyrë të ngjashme). Përderisa raportet e gatishmërisë janë një mjet kyç i lidershipit dhe menaxhimit, saktësia e raportimit duhet të përgëzohet, dhe lajmet e këqija në të nuk duhet të ndëshkohen. Raportet duhet të tregojnë:

- Vendet vakante ekzistuese të personelit,
- Humbjet e parashikuara në personel për shkak të një sërë arsyesh (pension, largim, emërimet të tjera, shkollë) brenda dy viteve në vijim, dhe
- Mungesa të personelit me aftësi kritike, të përkufizuara si ato pa të cilat njësi nuk mund të kryejë misionet e saj.

Pas një analize të detajuar të raporteve të gatishmërisë, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, nëpërmjet Shtabit të Përgjithshëm drejton dhe rialokon burimet për të përmirësuar nivelin e gatishmërisë së forcave të armatosura bazuar në kërkesat operacionale. Shpërndarja e burimeve bazohet në prioritetet e vendosura të burimeve.

Përcaktimi i Prioriteteve të Alokimit të Burimeve

Drejtorja J3 e Shtabit të Përgjithshëm, (Operacionet) çdo vit cakton një prioritet të burimeve për secilën njësi/organizatë të forcave të armatosura bazuar në kërkesat operacionale dhe stërvitore (dislokimet e ardhshme, mangësitë në stërvitje, mungesa të burimeve, etj.) parashikuar deri në tre vite. Rendi i prioritetit përbën udhëzimin për shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe materiale në të gjitha forcat e armatosura.

Tabela 2 më poshtë na jep një shembull të krijuar.

Resource Priority	Unit/Organization	Objective Manpower fill	Logistics Support Priority	Notes
Priority 1	2. Infantry Battalion, Zall Herr	≥ 90% of TOP	Priority 1	Designated for NATO
Priority 2	Naval Flotilla	≥ 80% of TOP	Priority 1	Required for maritime security/patrolling.
Priority 2	Transportation Battalion, Logistics Brigade	≥ 80% of TOP	Priority 2	Supports demilitarization.
Priority 3	Headquarters Battalion	≥ 75% of TOP	Priority 4	Can call on other support.
Priority 4	Regional Support Detachment Elbasan	≥ 70% of TOP	Priority 4	Supported by other detachments as needed.
	Etc.			

Figura 2. Shembull i Përcaktimit të Prioriteteve të Burimeve të Njësisë

Si edhe treguar në shembullin e mësipërm, batalioni i ofruar për NATO-n i jepet Prioriteti 1 si për personelin ashtu edhe për burimet materiale/logjistike. Objektivi është që të ngrihet dhe mbahet në nivelin e kërkuar prej 90% të gatishmërisë operacionale në kohë paqeje. Niveli më i lartë i gatishmërisë operacionale (statusi i personelit, stërvitjes, pajisjeve, materialeve, furnizimeve, etj.) caktohet sepse ky batalion i ofrohet NATO-s dhe duhet të stërvitet dhe të jetë i gatshëm për t'u dislokuar brenda një kohe shumë të shkurtër. Standardi i NATO-s është 90% në kohë paqeje. Kur i kërkohet të dislokohe, njësi nuk do të ketë kohë të stërvitë personel të ri. Në të njëjtën kohë, në shembull, Detashmenti i Mbështetjes Rajonale në Elbasan i jepet një nivel prioriteti i burimeve shumë më i ulët sepse mund të përforcohet shumë shpejt me njësi dhe kapacitete të tjera të forcave të armatosura nëse nevojitet. Përcaktimi i fuqisë njerëzore për të përmbushur përqindjet bazohet në kërkesat operacionale, eksperiencën dhe praktikitetin. Megjithatë, është një parim themelor që çdo njësi ushtarake me një personel më të ulët se 70% nuk mund të kryejë misionet dhe detyrat e tij në mënyrë efikase. Rrjedhimisht, parimi i përgjithshëm i menaxhimit të forcës njerëzore është që asnjë njësi të mos ketë një numër personeli më të ulët se 70% në të gjithë forcën. (Parimi i përgjithshëm përcakton kërkesën minimale absolute për personel në kohë paqeje në të gjithë Forcat e Armatosura. Në mënyrë specifike, numri i personelit në kohë paqeje nuk mund të lejohet të bjerë më poshtë se 70% e të gjithë forcës.)

Parashikimi i Kërkesave për Personel

Pasi prioritetet për personelin përcaktohen nga Drejtoria J3 e Shtabit të Përgjithshëm (Operacionet),



Drejtoria J1 (Personeli) dhe Qendra e Personelit dhe Rekrutimit (QPR) kanë përgjegjësinë të kujdesen që njerëzit e duhur, me kualifikimet e duhura, të emërohen në pozicionet e duhura sipas prioritetit. Kjo kërkon një sistem menaxhimi të personelit të centralizuar dhe aktiv i cili të identifikojë dhe lidhë vendet vakante që do të krijohen në strukturë me kandidatët e kualifikuar për ato vende. Duke parë para në kohë, sistemi i menaxhimit të personelit mund të sigurojë që individëve të përcaktuar për punët e reja t'u jepet trajnimi i nevojshëm për të kryer punën para se të emërohet në pozicionin e ri. Mësimi gjatë punës sigurisht që është i nevojshëm, por vetëm personat e kualifikuar duhet të emërohen në pozicionet e reja. TOP i automatizuar përcakton kërkesat për aftësi/kualifikime për secilin pozicion në forcat e armatosura. Në të njëjtën kohë, sistemi i automatizuar i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ndjek aftësitë, kualifikimet, nivelin e eksperiencës dhe njohurinë bazë të secilit individ të komunitetit të mbrojtjes. Integrimi i këtyre dy sistemeve lejon identifikimin, lidhjen, përzgjedhjen dhe emërimin e individëve plotësisht të trajnuar dhe kualifikuar për të përmbushur kapacitetet e aftësive të specifikuar në TOP. Kur përdoret në mënyrën e duhur, sistemi i Burimeve Njerëzore gjithashtu lejon planifikimin paraprak duke identifikuar individët të cilët kanë nevojë për trajnime/kualifikime të avancuara për t'i përgatitur për nivelet më të larta të përgjegjësisë dhe emërimeve. Kjo aftësi e planifikimit paraprak, e shoqëruar me përzgjedhjen konkurruese për arsimim dhe trajnim të avancuar, shërben për të siguruar një numër të përshtatshëm individësh plotësisht të trajnuar në forcat e armatosura. Implikimet e planifikimit paraprak të sistemit të menaxhimit të personelit janë dy anësh: Së pari, menaxhimi i personelit ka nevojë të jetë i centralizuar dhe të operohet nga profesionistë të mirë trajnuar të burimeve njerëzore. Së dyti, parashikimet e personelit bëhen baza për të përcaktuar numrin dhe llojin e performancës së bazuar në standarde në klasat e shkollës së trupës dhe klasat e trajnimit të aftësive gjatë punës që nevojiten çdo vit nga ushtria. Kërkesat do të ndryshojnë çdo vit, dhe sistemi i arsimimit/trajnimit duhet të jetë mjaftueshëm fleksibël për të përmbushur kërkesat që ndryshojnë. Aktualisht, sistemi i menaxhimit të Burimeve Njerëzore që përdoret nga Forcat e Armatosura përdor metodologjinë e zhvendosur të planifikimit dhe menaxhimit të ushtrisë së mëparshme të bazuar në shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Shpërndarja e individëve në të gjithë forcën ende mbështetet në lidhjet personale, dhe jo në kualifikimet profesionale të individëve. Anëtarët e forcave të armatosura shpeshherë emërohen bazuar në kontaktet dhe disponueshmërinë personale, dhe kjo pengon ndjeshëm zhvillimin e ushtrisë më të mirë të vogël në NATO. Sistemi i Burimeve Njerëzore i Forcave të Armatosura ka nevojë të evoluohet duke centralizuar dhe zhvilluar një proces largpamës, robust dhe zhvillim të ciklit jetësor të karrierës (intelektual dhe praktik) që të përgatisë në mënyrë aktive secilin individ për gradë më të lartë dhe përgjegjësi më të mëdha.

ANALIZA

Opsionet e SHBA-së për sanksionet e paefektshme ndaj Ruisisë

Shtetet e Bashkuara njoftuan sanksione të reja mbi shtatë zyrtarë të qeverisë ruse më 28 prill. Një taktikë e përdorur gjatë, sanksionet mund të japin efekte të paparashikueshme ose nuk kanë efekt fare, varet se si janë hartuar. Supozohet se zakonisht sanksionet zbatohen kur veprimet e një vendi të synuar konsiderohen të papranueshme. Me sa duket, kombi sanksionues zgjedh sanksione për të shmangur luftën kur lufta mund të jetë shumë e kushtueshme ose mund të rezultojë në humbje. Qëllimi deklaruar i sanksioneve është të nxisë ndryshime të sjelljes në një shtet të synuar duke shkaktuar dhimbje ekonomike. Që të funksionojnë, sanksionet duhet të shkaktojnë dhimbje, por ato nuk duhet të jenë shumë të ashpra në mënyrë që të bindin shtetin e synuar që lufta është më e dëshirueshme se sa kapitullimi ndaj kërkesave të kombit që sanksionon.

Kur sanksionet funksionojnë mjaft mirë

Në korrik të vitit 1941, kur japonezët pushtuan Indo-Kinë, Shtetet e Bashkuara u përgjigjën duke ngrirë të gjitha asetet japoneze. Mbretëria e Bashkuar dhe India Lindore Holandeze (Indonezia e sotme) e pasuan. Sanksionet ishin mjaft efektive dhe Japonisë iu bë dalje nga pjesa më e madhe e tregtisë ndërkombëtare, duke humbur 90 për qind të naftës së saj të importuar. Japonisë iu desh të përgjigjej, por në vend të tërheqjes nga Indo-Kina, ajo sulmoi Pearl Harbor. Shembulli japonez është konsideruar me vlerë. Shtetet e Bashkuara e vendosën Japoninë në një situatë ku furnizimet e saj të naftës do të varfëroheshin në pak muaj dhe në atë pikë Japonia do të pushonte së qeni një fuqi industriale. Tokio mund t'i pranonte kushtet amerikane, por sapo ta bënte këtë, ajo do të vendoste veton amerikane mbi vendimet japoneze. Japonezët nuk

besonin tek Shtetet e Bashkuara dhe ishin të bindur se çdo kapitullim sanksionesh thjesht do të çonte në më shumë kërkesave të SHBA-së. Tokio i kuptoi rreziqet e luftës, por llogaritë se këto rreziqe ishin më të pakta se rreziqet që vepronin në përputhje me kërkesat e SHBA-së (edhe pse japonezët mund t'i kenë bërë gabim këto llogaritje dhe se Franklin Roosevelt mund ta ketë ditur se Tokio do të zgjidhte luftën kundrejt kapitullimit). E përballur me sanksionet që do të paralizonin vendin, Japonia zgjodhi luftën. Sanksionet funksionojnë më mirë kundrejt kombeve që nuk kanë opsione hakmarrëse, duke përfshirë edhe opsionin për zhvillimin e luftës. Irani është një shembull i një objekti të përsosur për sanksione. Pa një pajisje bërthamore të prodhuar, ai nuk ka mundësi për të zhvilluar luftë dhe ka disa mënyra të tjera për t'u hakmarrë. (Megjithatë edhe me vende si Irani, sanksionet mund të kenë një efekt të kufizuar në qoftë se objektivi mund të gjejë mënyra t'i shmangët sanksioneve).

Sanksionet e udhëzuar në mënyrë precize

Vendosja sanksione efektive në një vend si Rusia është shumë më e komplikuar se sa vendosja e tyre në vende si Irani dhe Republika e Afrikës Qendrore, sepse rusët kanë përgjigje potenciale ushtarake. Gjithashtu, ato kanë aftësinë për t'u hakmarrë me sekuestrimin e aseteve perëndimore në Rusi: Ka shumë kompani perëndimore që bëjnë biznes në Rusi me pajisje të rëndësishme, fabrika, llogari bankare dhe kështu me radhë. Moska gjithashtu ka fuqinë për të prerë furnizimin me energji të Europës. Nëse do të ishte e kujdesshme për Rusinë që të përgjigjej në këto mënyra është një pyetje e rëndësishme, por fakti që Rusia ka një sërë mundësish hakmarrëse është një konsideratë e rëndësishme. Pjesërisht për këtë arsye dhe pjesërisht për shkak të një teorie sanksionesh që është shfaqur vitet e fundit, Shtetet e Bashkuara dhe disa vende europiane kanë zgjedhur t'i vendosin sanksione Ruses si një

Moska gjithashtu ka fuqinë për të prerë furnizimin me energji të Europës. Nëse do të ishte e kujdesshme për Rusinë që të përgjigjej në këto mënyra është një pyetje e rëndësishme, por fakti që Rusia ka një sërë mundësish hakmarrëse është një konsideratë e rëndësishme.



e tërë. Në vend të kësaj, ata kanë vendosur sanksione mbi individët dhe një numër të vogël kompanish në Rusi që konsiderohen përgjegjës për veprimet në Ukrainë që Shtetet e Bashkuara dhe Europa i konsiderojnë të dënueshëm. Ne mund t'i quajmë këto "sanksione të udhëzuar në mënyrë precize" ose sanksione të destinuar për të detyruar një ndryshim në drejtim, pa shkaktuar dëme anësore apo të rrezikojnë hakmarrje të rëndësishme. Ideja e vendosjes së sanksioneve ndaj regjimeve dhe jo kombeve e ka origjinën në faktin e qartë se nëse janë të suksesshëm, sanksionet ndaj kombeve dëmtojnë të gjithë popullsinë, shumica e të cilëve janë të pafajshëm dhe të pafuqishëm, duke lënë udhëheqësit, të cilët kanë krijuar krizën në pushtet, të lirë për të zhvendosur barrën tek popullsia. Shembulli i Irakut është cituar shpesh. Atje, një regjim i fortë sanksionesh ekonomike është vendosur në vend, duke pakësuar shumë standardet irakiane të jetesës e duke lejuar udhëheqjen të përfitojë nga shtigjet e ndryshme të destinuarara për të lehtësuar barrën e publikut. Nga kjo dhe përvojat të tjera ka dalë ideja e sanksioneve ndaj udhëheqësve të veçantë për të shmanhur dëmtimin e publikut të gjerë. Kjo qasje ka dominuar përgjigjen e perëndimorëve ndaj veprimeve ruse në Ukrainë. Duke sulmuar interesat ekonomike të udhëheqësve kryesorë rusë, ose të paktën të qarqeve të tyre së brendshme, Perëndimi duket



se po përpiqet të forcojë ndryshime në politikën e Rosisë drejt Ukrainës. Kjo ngre një numër pyetjesh të rëndësishme.

Kufizimet e sanksioneve ndaj Rosisë

Së pari, ngrihet pyetja nëse udhëheqësit rusë kanë më shumë për zemër pushtetin apo paratë. Në vitet '90, paratë gjeneronin pushtet, por tani janë më të theksuara: Ata me fuqi dhe ata me para janë të njëjtit. Prandaj është e vështirë të imagjinohet se regjimi i Putin do të ndryshojë politikën dhe në këtë mënyrë të pranojë dobësinë, një gabim fatal për të gjithë në pushtet për të ruajtur një pjesë të fatit së anëtarëve të saj. Për më tepër,

udhëheqja ruse ka mbajtur disa nga paratë e saj brenda Rosisë për të shmangur konfiskimin nga qeveritë perëndimore. Sigurisht, disa nga paratë e udhëheqjes kanë rrjedhur nga Rusia, por jo të gjitha. Njerëzit që janë në shënjestër nuk do të vendosen papritur në listat e mirëqenies në Rusi, për shkak të sanksioneve të tanishme. Individët në shënjestër do t'u përgjigjen sanksioneve të SHBA-së me indiferencë. Ata mund të humbasin disa asete në gjuetinë e thesarit që do të pasojë, por rritja e popullaritetit së tyre të brendshëm do ta kompensojë këtë, një rritje që ndoshta kushton jo më shumë se sa mund të ngarkojë një firmë e marrëdhënieve publike me fuqi të madhe në Uashington. Duke pasur parasysh



pozitat e tyre, ata me siguri mund të fitojnë përsëri çdo gjë që mund të humbasin nga konfiskimet. Së dyti, ngrihet pyetja e aseteve të ndërthurura. Udhëheqësit rusë kanë investuar në shumë kompani ruse me interesa në kompanitë perëndimore. Në disa raste, ata janë përfshirë në ndërmarrjet e përbashkëta me kompanitë perëndimore. Për të ilustruar dilemën perëndimore, le të supozojmë se ka një ndërmarrje të përbashkët midis Rosneft dhe një kompanie perëndimore naftë. Si procedon ekzaktësisht Perëndimi me sanksionet në një situatë të tillë? A i konfiskon të gjitha apo vetëm disa nga asetet e ndërmarrjes së përbashkët? Çfarë përgjegjësie shkakton mbi aksionerët e tjerë, perëndimorë dhe rusë, të cilët nuk janë në listën e sanksioneve? Tani konsideroni një investim në një firmë kapitali privat amerikan nga një fond meksikan me investitorë nga Qipro, i cili mund të përfshijë njerëz në listën e sanksioneve. Në kapitalizmin modern, shtigjet e investimeve mund të jetë me të vërtetë të gërshetuar. Dikush mund të jetë në gjendje të gjejë pasuritë në një vend relativisht të vogël me asete të kufizuara, por Rusia është ekonomia e tetë më e madhe në botë dhe pasuria e saj është e ndërthurur me objektivat e sanksioneve, duke komplikuar mjaft sfidën e sanksioneve efektive të udhëzuar në mënyrë precize. Së treti, ngrihet pyetja politike. Popullariteti i presidentit rus, Vladimir Putin, është rritur me shpejtësi pas aneksimit rus të Krimesë. Ashtu si në Perëndim, udhëheqësit rusë që shfaqen se veprojnë me vendosmëri në krizat e huaja, gëzojnë shkallën më të lartë të kënaqshmërisë, të paktën fillimisht. Putin mund ta ketë të vështirë për mos t'ju përgjigjur sanksioneve, sepse në rast se ai dështon së vepruari, mund të humbasë një pjesë të popullaritetit së fituar nga pamja e forcës së tij.

Sanksionet qëllimisht të paefektshëm

Përveç kësaj, Shtetet e Bashkuara nuk duan të kërcënojnë mbi jetesën e regjimit në një vend me fuqi masive ushtarake dhe as nuk

duan të angazhohen në një veprim që do të shkaktonte një pushtim të Ukrainës dhe të detyrojë Shtetet e Bashkuara që të bashkohen në një luftë për të cilën nuk është e papërgatitur. Gjithashtu do të përpiqet të shmangë sekuestrimin gabimisht të aseteve amerikane dhe europiane, asete të vendosur nga Rusia me qëllim për të nxitur Uashingtonin të bëjë një gabim të tillë. Administrata Obama ka një arsye përfundimtare të madhe për të shmangur sanksionet efektive. Nëse dikush do të kishte thënë një vit më parë se marrëdhëniet SHBA-Rusi do të arrinin në pikën e tanishme, do të ishte përqeshur, diçka për të cilën mund të dëshmoj. Investimet e huaja janë një komponent i rëndësishëm për ekonominë amerikane dhe udhëheqësit e shquar politikë janë një burim i shkëlqyer i kapitalit. Nëse jeni udhëheqës të Kinës, Arabisë Saudite apo Indisë, të cilat kanë probleme me Shtetet e Bashkuara, duhet të mendoheni dy herë para se

të investoni paratë tuaja në Shtetet e Bashkuara dhe ka më shumë vende se këto të katërt që kanë konflikte të mundshme me Shtetet e Bashkuara. Për këtë arsye, sanksionet strategjike të SHBA-së nuk janë projektuar për të ndryshuar politikën ruse, ato janë projektuar të bëjnë të duket se Shtetet e Bashkuara po përpiqen të ndryshojnë politikën ruse. Kjo ka për qëllim ata në Kongres që e kanë bërë këtë një problem të madh dhe në ato pjesë të Departamentit të Shtetit që duan të orientojnë politikën e sigurisë kombëtare të SHBA-së rreth çështjes së të drejtave të njeriut. Mund të thuhet se diçka po bëhet ose të dy palët mund të pretendojnë se diçka po bëhet, kur në fakt nuk mund të bëhet asgjë. Në një botë që ankohet për veprim, liderët e matur ndonjëherë preferojnë në dukje se po bëjnë diçka se sa në fakt ta bëjnë atë.

**Përgatiti: Alba Musaraj
Burimi: STRATFOR**



MARRËDHËNIET SHBA-RUSI



Nëse dikush do të kishte thënë një vit më parë se marrëdhëniet SHBA-Rusi do të arrinin në pikën e tanishme, do të ishte përqeshur, diçka për të cilën mund të dëshmoj. Investimet e huaja janë një komponent i rëndësishëm për ekonominë amerikane dhe udhëheqësit e shquar politikë janë një burim i shkëlqyer i kapitalit.



26 studentë ushtarakë nisen për trajnim në New Jersey, SHBA

Ambasadori Arvizu: Vizioni i këtij programi ka frymëzuar shumë persona që shërbejnë në FA shqiptare
Ministrja e Mbrojtjes, Kodheli: Pritshmëria jonë ndaj jush është vërtet e lartë, ndaj bëni gjithçka që duhet që ne të gjithë të ndihemi krenarë me ju

“BLAC





“KEAGLE 001”



Koalicioni Antifashist dhe fitorja e popujve mbi fashizmin

Me rastin e 9 majit, ditës së fitores mbi nazi-fashizmin, njëkohësisht edhe dita e Europës

NË FOTO: Helmeta e një ushtari amerikan të vrarë në zbarkimin e Normandisë, plazhi francez ku në datë 6 qershor 1944 u krye zbarkimi i trupave aleate amerikane për të dhënë goditjen përfundimtare ndaj forcave naziste. "Ne nuk mund dhe nuk duhet të harrojmë se dita e zbarkimit aleat ishte dita dhe vendi ku trimëria dhe altruizmi i disave mundi të ndryshojë rrjedhën e një shekulli të tërë", - do të thoshte Presidenti amerikan, Obama, para disa vitesh gjatë përkujtimit të 65 vjetorit të kësaj ngjarje që vërtet ndryshoi një herë e përgjithmonë fatet e botës...



KOALICIONI ANTIFASHIST DHE FITORJA E POPUJVE MBI FASHIZMIN



Humbje fatale,
mirazh në shkretëtirë



Betejat kryesore,
rezistenca e popujve



Kontributi i Shqipërisë në fitoren
e koalicionit antifashist botëror

PROF. DR. PAJTIM RIBAJ
PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

69-vjetori i Koalicionit Antifashist dhe fitoren e popujve mbi fashizmin na shtyn të ritheksojmë e të ngremë vlerat e kësaj epopeje, të kësaj lufte në historinë botërore, si dhe nevojën për vlerësimin sa me objektiv të Luftës Antifashiste të shqiptarëve. Ngjarjet dhe vitet e Luftës së Dytë Botërore nuk shterin dhe dokumente e materiale vijojnë të hulumtohen dhe të plotësohen. 9 Maj 1945, në Berlin në prani të aleatëve Zhukov, Tedder, Spetz, e De Latre dhe të gjermanëve Ketel, Feidburg e Stumpf, u zyrtarizua kapitullimi i nazizmit. Konflikti më i tmerrshëm në historinë e njerëzimit ka qenë deri më sot Lufta e Dytë Botërore. Në këtë luftë u përfshinë popullsia, ekonomia dhe burimet natyrore të 61 shteteve. Luftimet u zhvilluan nga Atlantiku deri në Paqësor dhe morën pjesë 110 milionë ushtarë. U përdorë teknika në shifra kolosale ku vetëm avionë, tanke dhe topa numëroheshin mbi 2 milionë e 400.000 copë. Lufta e Dytë Botërore shpërtheu për shkaqe të thella ekonomike, shoqërore e politike. Tronditja e thellë që shkaktoi kriza ekonomike, erdhën në fuqi regjime fashiste të fuqishme e agresive të cilat të ardhmen e tyre ideologjike politike dhe ekonomike e bazuan në përgatitjen për luftë. Nga viti 1931 e më pas, ekuilibri jetëshkurtër, që u vendos në botë pas Luftës së Parë Botërore dhe që "ruhej" nëpërmjet Traktatit të Versajës në Evropën, e Paktit të Uashingtonit në Oqeanin Paqësor po prishej, ku përfshiu shembjen e Lidhjes së Kombeve dhe të sigurimit kolektiv. Në ndërtesën e paqes u hapën papritur vatrat e para të frikshme të luftës, duke ushtruar presion e cila më pas do të zotëronte më pas tërë globin. Në vitin 1931 Mançuria, e cila mund të konsiderohet fillimi i Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1935 Etiopia, në vitin 1936 Spanja, Çekosllovakia në vitin 1938, në prill 1939 Shqipëria dhe në shtator 1939 Polonia, që shënon fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe të zbatimit të teorisë "të hapësirës jetike" të Hitlerit.

Koalicioni Antifashist

Formimi i Koalicionit Antifashist diktohej nga nevoja e luftës kundër fashizmit që kish vënë në shenjë lirinë dhe zhvillimin progresiv të

njerëzimit. Fuqia ushtarake e Koalicionit Antifashist Botëror me në krye Anglinë, Bashkimin Sovjetik e SHBA, u bë forca morale e materiale e popujve, kundër makinës së madhe ushtarake të nazizmit gjerman, të fashizmit italian, militarizmit japonez e satelitëve të tyre si Finlanda, Austria, Hungaria, Bullgaria, Rumania etj. Koalicioni antifashist është aleanca më e gjerë që njihet në të gjithë historinë diplomatike e që përfshiu 51 shtete në fund të luftës. Të gjithë popuj e forca përparimtare të bashkuara nga një qëllim i madh për ti prerë rrugën mortajës nazifashiste. Qëllimit fisnik të koalicionit i priu një lëvizje e gjerë diplomatike. Kështu më 22 qershor 1941 kryeministri britanik Çerçill dhe më 24 qershor presidenti amerikan Rusvelt në emër të qeverisë së tyre shpallën mbështetjen ndaj BS, në luftën kundër Gjermanisë fashiste. Më 9-12 gusht 1941 u zhvillua Konferenca



Anglo-Amerikane prej nga doli dokumenti që mori emrin e përfaqësuesve të BS, Belgjikës, Çekosllovakisë, Greqisë, Polonisë, Holandës, Norvegjisë, Luksemburg dhe të Francës së Lirë. Më 29 shtator-1 tetor 1941 në Moskë mbahet Konferenca e tre Fuqive të Mëdha, Angli, BS e SHBA, të cilat nënshkruan deklaratën për ndihmë ndaj BS, që mbante peshën kryesore të luftës. Sipas protokollit SHBA e Anglia prej atij momenti (1 tetor) deri në korrik 1942 do të dërgonin në BS çdo muaj 400 aeroplanë, 500 tanke, makina, aluminë, etj. Me sulmin e Japonisë në Përl Harbor, përkrah SHBA-së kundër Japonisë, u rreshtuan Australia, Zelanda e Re, Kanada, Bashkimi Jugafrikan, India,

një seri vendesh Amerikano-Latine, Komiteti Kombëtar "i Francës së Lirë", qeveritë e Polonisë, Greqisë, Irakut, Egjiptit, Çekosllovakisë e Kinës. Pas betejës së Moskës dhe hyrjes së SHBA në luftë lidhjet midis tre Fuqive të Mëdha dhe popujve antifashiste u bënë më të fuqishme. Në janar 1942 në Uashington është nënshkruar deklarata e 26 shteteve e njohur si "Deklarata e Kombeve të Bashkuara", ku konfirmohej e shpallej përdorimi i të gjithë forcave të tyre ushtarake, ekonomike në luftë kundër fashizmit dhe të bashkëpunimit me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë u përcaktuan qartë pjesëmarrësit e koalicionit të shteteve ndërluftuese. Padyshim, "Konferenca e Pezës ishte reflektim i parë antifashist në Shqipëri në përputhje me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara të 1 janarit 1942". Pjellë e kësaj konference ishte e gjithë qëndresa antifashiste që hap pas hapi me zgjerimin dhe forcimin e saj pati jehonë dhe mbështetje prej kombeve të Bashkuara Antifashiste e sidomos prej Fuqive të Mëdha aleate. Për hir të së vërtetës duhet thënë se edhe mbreti Zog, bile i mbështetur nga emrat e njohur të emigracionit shqiptar si Noli, Konica, Çekrezi, Zavalani, Logoreci etj., bëri përpjekje megjithëse pa sukses, për aderimin e Shqipërisë në Deklaratën e Uashingtonit.

Betejat kryesore, rezistenca e popujve

Janë të shumta ndeshjet balllore midis forcave të bllokut nazifashist e atyre aleate me beteja të përgjakshme e privacione të pafundme që çuan në dëmtimin deri në shkatërrimin e mortajës fashiste. Beteja e Londrës, që shënon pa dyshim "të paktën qëndresën si dhe të parën disfatë që i shkaktua Hitlerit në çmendurinë e tij shkatërrimtare". Beteja e Moskës, e famshmeja e Stalingradit; El Alamein. Kursku, zbarkimi në Sicili, Normandia, që shënon hapjen e Frontit të Dytë etj., do të vijojë me Betejën e Berlinit e ndeshjet në Lindjen e Largët kundër militaristëve Japonezë, duke shënuar dhe fundin e Luftës së Dytë Botërore. Pa dyshim përkrah fuqive aleate do të përvijojë dhe rezistenca e popujve e vendeve të koalicionit Antifashist. Por me gjithë ndihmën e aleatëve në vitet 1940 rezistenca mbeti larg kërkesave të asaj lëvizjeje të gjerë masive popullore që do të shpërthente më pas. Shenjat e para të ndryshimeve cilësore u vunë në Shqipëri, Greqi, Jugosllavi, vende në të cilat "kundër-



përgjigja popullore ishte e gjerë e menjëhershme dhe inkandeshente". Në këto vende "u krijuan formacione të fuqishme partizane e çlirimtare të cilat kryen luftë të vendosur aktive kundër okupatorëve". E fuqishme do të zhvillohej lëvizja në skajin tjetër të Evropës sidomos në Francë apo lëvizja e "guerux" (leekamanët) në Holandë, që u pagëzuan më këtë emër në kujtim të revoltës së vendeve të ulëta kundër pushtimit spanjoll në Shek. XVI. Lëvizja e rezistencës gjeti terren deri në kampet naziste të punës, bile dhe në kampet e vdekjes si në Buhenvald, Mathauzen, etj. Ndërkohë është i njohur veprimtaria e grupeve "Rote Kapelle" dhe "Rosa Bianca" në Gjermani. Në kushtet përkatëse u zhvillua lëvizja e rezistencës në vendet e Azisë të okupuara nga Japonia. Në prapavijën Japoneze, në Kinë vijonin veprimet forcat e fuqishme partizane (A-8,4); veprime aktive luftarake çlirimtare zhvilluan atdhetarët birmanezë, koreanë, vietnamez,



filipinas, në malajë etj. Veçori e rëndësishme e luftës Antifashiste e cila gjeti shprehjen në luftën e popujve kundër pushtuesve fashistë ishte karakteri i saj mbarë-nacional, që përlligjej nga detyrat e përbashkëta të luftës kundër okupatorëve fashistë, ndihma reciproke e reparteve nationale deri në përndarje shumë kombëtare të reparteve. Ndërkohë në shumë vende të Evropës të okupuara nga fashistët në radhët e partizanëve luftuan me dhjetëra mijëra luftëtarë rus, anglezë, amerikanë, etj. Kështu në Shqipëri nga 15 mijë ushtarë italianë që u dorëzuan pranë formacioneve partizane, një numër prej 2.250 veta u futën në përbërje të formacioneve partizane prej të cilëve 472 u rreshtuan në përbërje të brigadave sulmuese, 401 hyn në shërbim të prapavijës, pjesa tjetër prej 1.277 veta u angazhuan pranë komandave të vendit. Po kështu numërohen rreth 200 luftëtarë të tjerë, shumica armenë dhe një pakicë nga kombësitë e tjera rus, turkmen, francez, çek, polak e deri gjerman, kryesisht të dezertuar nga radhët e ushtrisë naziste në Shqipëri apo të liruar nga kampet e internimit nga partizanë shqiptarë. Këta luftëtarë të huaj së bashku me partizanët shqiptarë shpesh u shquan për veprime të guximshme dhe shpirt heroizmi. Në këtë kah njihet veprimtaria luftarake e batalionit "Antonio Gramshit" por dhe e formacioneve më të vogla me italianë apo kombësi të tjera. Nga radhët e italianëve ranë 73 luftëtarë gjatë veprimeve luftarake kundër pushtuesve nazifashist dhe u shpallën dëshmorë të Shqipërisë. Ndërsa nga luftëtarët e kombësive të tjera dhanë jetën 24 prej tyre. Tashmë është e njohur veprimtaria e misioneve aleate në Shqipëri, Ballkan e gjetkë. Ne shqiptarët u jemi mirënjohës misioneve aleate që në përgjithësi u treguan ushtarakë të devotshëm, besnikë të misionit të tyre, që përballuan privacione të shumta të luftës partizane në një terren malor e me kohë të keqe, shpesh me mungesa në ushqime e veshmbathje, privacione që çuan deri në humbjen e jetës në emër të lirisë etj. Vetëm nga misionarët anglezë (më i madhi në numër dhe në kohëzgjatje, 18 muaj) dhanë jetën 84 luftëtarë, 37 të gjetur prehen sot në Monumentin e ngritur në kodrat e Liqenit Artificial të Tiranës. Midis komandave partizane të vendeve fqinje u realizuan bashkëveprim luftarak i ngushtë, bashkëveprim i tillë ishte vendosur midis francezëve dhe partizanëve

italianë. Një radhë veprimesh të përbashkëta kryen partizanët italianë e jugosllavë; për herë pati bashkëveprim midis formacioneve shqiptare e jugosllave, shqiptare e greke, franceze e belge, jugosllavë e bullgarë, grekë e jugosllavë, etj.

Terrori nazist

Kushdo që ka jetuar ve pushtuar nga nazifashistët edhe sot i shfaqet si një kuadër i vetëm dhunë dhe terrori sipas një skeme të vetme të Rajhut të Tretë, gjatë periudhës nga "Drole de Guerra" deri në shembjen e Francës dhe Betejën e Londrës, Hitleri kishte objektiv stabilizimin e rendit të ri nëpërmjet qeverive kuislinge (sipas emrit të kolaboracionistit Norvegjez që e hapi i pari këtë lojë). Sipas R. Batalias, Polonia është ndoshta kombi i vetëm që nuk u gjend qoftë edhe një kuisling që të bashkëpunonte me fashizmin, dhe kjo do të përbënte krenarinë e përjetshme të historisë së saj. Ndoshta edhe për këtë fakt, Polonisë iu rezervua një vend i veçantë në planin e nazizmit për "gjermanizimin e Lindjes". Terrori nazist është i paimagjinueshëm sidomos ndaj hebrenjve që Hitleri e konsideronte si kusht për rendin e ri. Në kampet e përqendrimit, pjella perverse të famëkeq Herman Gering e Hajrih Himler do riprodhohej e zbatohej thënia cinike e Hitlerit "unë kam të drejtë të zhdruk miliona njerëz të racës më të ulët, që shumohen si krimba". Nuk mund të harrohet 9-10 nëntori 1938, i cili ka hyrë në histori me emrin "Nata e Kristaltë", ku në territorin e Rajhut të Tretë shpërthyen përndjekjet raciste më të tmerrshme të historisë e ku kërkohet hapja e dyerve të Kampit të përqendrimit të Buhenvaldit e nga ku hierarku nazist Hajdriu urdhëronte të ligjërohej "gjuetia e njerëzve", apo "Endlosungun" që synonte shfarosjen totale të 11 milion hebrenjve në Evropë, për të cilën u krijua ushtria e shfarosjes "Einisatgruppen". Trupa të specializuara që shkonin pas armatave të Rajhut të Tretë. Ndoshta tragjedia e getos në Varshavë ku 1/3 e popullsisë u mbyll në 1/20 e territorit e ku u shfarosën 300 mijë hebrenj ishte me tragjikja. Po kështu në qershor 1941 kur popullsia civile e Kretës u hodh në luftë për hakmarrje do të shfarosej nga gjermanët pjesa më e madhe e saj, e qindra akte të nazistëve që kujtesa e popujve nuk mund ti harrojë.





Humbje fatale, mirazh në shkretëtirë

Humbja njerëzore e Luftës së Dytë Botërore është shumë e madhe. Shifrat e sakta për humbjet e pjesëmarrësve nuk janë gjithmonë të vlefshme dhe këto që janë, disa janë konsideruar zakonisht si të pabesueshme. Vlerësimi më i mirë llogaritet listën e të vdekurve përafërsisht në 50.000.000. Padyshim humbjet e BS ishin më serioze. Shuma totale më e mundshme e të vdekurve ushtarakë dhe civilë është ndoshta 20.000.000 përveç kësaj në krahinat e pushtuara nga gjermanët mbi 2/3 e shtëpive dhe qendrave të prodhimit ishte shkatërruar. Aleatët perëndimorë dolën më pak të dëmtuar. SHBA patën 300.000 të vdekur, Britania nën 500.000 dhe vendet e Mbretërisë Britanike një shtesë prej 120.000 më pak se sa humbjet e Mbretërisë Britanike në Luftën e Parë Botërore. Humbjet gjermane ishin mbi 4.500.000 nga të cilët 1.000.000 ishin civilë, shumica të shkaktuar nga nazistët ndaj popullit të vet. Forcat Aziatike patën humbje më të rënda. Humbjet japoneze ishin 2.000.000. Italianët humbën mbi 500.000 vetë. Përveç BS humbjet e rënda ishin në Kinë. Vlerësimet e humbjeve kineze llogaritin rreth 10.000.000 ushtarak e civilë. Gjenden edhe disa shifra të tjera për të vdekurit, gjatë në Azi, por është e njohur që 1.500.000 vdiqën në Bengal nga uria në verën e vitit 1943. Më tepër mund të bëhej për të lehtësuar këtë disfatë, në qoftë se transporti detar dhe hekurudhor do të lihej i lirë nga kërkesat e luftës. Në Evropën Qendrore dhe Lindore, më tepër se 5.500.000 hebrenj të vrarë nga nazistët dhe shumë civilë jo hebrenj u vranë gjithashtu nga nazistët. Rekordi karakteristik i partizanëve Jugosllavë nuk u arrit pa një çmim. Ndoshta 1.000.000 civilë jugosllavë vdiqën në duart e gjermanëve dhe në luftë për mbrojtjen e vendit të tyre. mbi 4.000.000 nga vendet e tjera të Evropës Lindore vdiqën, ndërsa Forcat e Armatosura të Jugosllavisë, Hungarisë, Polonisë e Rumanisë humbën së bashku 300.000-400.000. Bullgaria pati humbjet më të pakta 20.000. në Evropën Perëndimore, Franca humbi 500.000 vetë, gjysma e të cilëve civilë. Holanda

humbi 200.000 civilë. Belgjika dhe vendet Skandinave së bashku pësuan dëme të rënda në krahasim me popullsitë e tyre të vogla. Ndërkohë humbjet janë të pallogaritshme në vlerë materiale. Qytete, fshatra, vepra të mëdha prodhimi, deri çudira të arritjeve të artit të shkencës e teknikës, të ngritur nga dora e brezave gjatë shekujve me djersë e gjak u kthyen në gërmadha. Në fund të fundit edhe me Luftën e Dytë Botërore u vërtetua, siç shkruan Liddell Hart "mësimet e nxjerrë nga historia se fitorja nuk është veçse një mirazh në shkretëtirë, pas gjithë asaj luftime të egër e të gjatë të zhvilluar me përdorimin e armëve më moderne të kohës dhe me metoda që nuk njohin as një kufi". Kjo luftë veç të tjerash u pagua jo vetëm me jetën e dhjetëra miliona njerëzve, me një shkatërrim të pallogaritshëm fizik, por edhe "me një prishje të ekuilibrit të forcave në kontinent me çmimin që Evropa Perëndimore u bë në mënyrë të rrezikshme ndoshta fatale e cenueshme nga fuqia sovjetike..." ishin këto realitete tragjike të prishura që motivonin një nga parashikuesit dhe një nga opozitarët më të mëdhenj gjerman në kohën e Hitlerit duke i shkruar me rrezik jetë një letër një shoku të tij gjatë luftës thoshte: "Për ne, Evropa e pasluftës nuk është as çështje kufijsh, ushtarësh, organizatash të mbingarkuara dhe planesh të mëdha, sesa çështja së si të ringjallet figura e njeriut në kraharrorët e bashkëqytetarëve tanë". Sikur nazistët ta kishin kursyer këtë njeri për të tashmen dhe të ardhmen shkruan Kennan, ai ishte i drejtë edhe i guximshëm dhe njerëz të tillë do të kërkohen me dëshpërim në të ardhmen.

Shqipëria dhe koalicioni

Midis protagonistëve të kësaj ndeshjeje të madhe e tragjike, që ka njohur historia botërore qëndron dhe populli shqiptar, si ndër luftëtarët më aktiv e syptrembur të Koalicionit Antifashist, i vendosur të luftojë deri në fund për atë çështje që është detyra më e madhe, më e shenjtë e kohës, për të cilën asnjë mundim e humbje, asnjë fli e sakrificë njerëzore e materiale e tij nuk ishte e

tepër dhe e shtrenjtë për çështjen e lirisë, të pavarësisë e të ekzistencës së tij si komb. Populli shqiptar është i pari në Ballkan ndoshta edhe në Evropë që nisi luftën me armë kundër pushtuesve fashistë në kushte tepër të vështira. Krismat e dyflekëve të rezistencës shqiptare në atë fillim të vitit 1939 nuk ishin natyrisht aq të fuqishme sa të topave që gjëmuan në vjeshtë të atij viti (Polonia). Por ato ishin lajmëtarët e para që dëshmonin se agresorët fashistë nuk do të ishin marshime fitimtare siç mendonte Duçe e Hitler. Ndërkohë lidhjet e ushtrisë së tij me Luftën Antifashiste Botërore populli shqiptar asnjë herë nuk e kuptoi si një aderim apo solidarizimi të thjeshtë, por një angazhim total të së gjithë strategjisë e taktikës së tyre të së gjitha forcave dhe mjeteve që dispononin për shkatërrimin përfundimtar të fashizmit. Si "një nga faqet më të ndritura të popullit, më madhështore dhe njëra prej përpjekjeve më titanike të kombit tonë në gjithë historinë e tij", Lufta Antifashiste si një përmendore e luftës për liri do të shkëlqejë përherë në një dritë e pashuar, në panteonin e lavdishëm të historisë mijëra vjeçare të kombit shqiptar. Për të gjithë popujt në rrjedhën e viteve e të shekujve ka ngjarje e bashkë me të edhe personalitete që për domethënien e tyre qëndrojnë si udhërrëfyes, në udhëkryqet e mëdha të historisë dhe dihet se rreshtimi i Luftës Antifashiste në kuadrin e koalicionit antifashist botëror përbën nga ato ngjarje për të cilën mund të thuhet se pa të, rrjedha e historisë mund të kishte qenë e detyruar të merrte tjetër rrugë e të shembte çka kishin ndërtuar vite e shekuj. Populli shqiptar duke qenë vetë i robëruar gjatë gjithë historisë së tij ka patur një ndjenjë të lartë solidariteti me popujt që luftonin për çlirimin kombëtar kundër zgjedhës së huaj. Të paktën që nga koha e Skënderbeut e vazhdimisht vullnetarë shqiptarë janë gjetur në fushat e betejave çlirimtare të popujve fqinjë që nga Greqia, Rumania, Bullgaria e deri tek Garibalidi, por Lufta Antifashiste në koalicionin Botëror i dha një kuptim e përmbajtje të re këtij solidariteti. Qëndrimet e reja dhe shqyrtimi objektiv e realist i situatës së krijuar nga lufta e hapur, rrugën e afrimit dhe bashkëpunimit me Luftë Antifashiste të popujve fqinjë të Jugosllavisë e Greqisë. Qëndrimet humane të mbajtura ndaj ushtarëve italianë që mbetën të braktisur në Shqipëri pas kapitullimit të Italisë fashiste, e sidomos qëndrimit nga hebrenjve ndaj luftës. Vetë qeveria shqiptare nxori vendime për mbrojtjen e Hebrenjve. Këtyre u janë dhënë dhe pasaporta shtetërore shqiptare (duke përdorur emra të ngjashëm) vetëm që t'u bëhej e mundur mbijetesa në Shqipëri. Shqipëria është vendi i vetëm ku Hebrenjtë u shtuan nga 200 në 2000 veta gjatë Luftës së Dytë Botërore. Dhe kjo është meritë



e të gjithë shqiptarëve. Analiza e marrëdhënieve të Luftës Antifashiste të Shqipërisë me lëvizjet çlirimtare të vendeve fqinjë tregon se dhe në ato kushte e rrethana tepër të vështira ku viheshin në balancë fatet e popujve kanë patur tek Shqipëria dhe Lufta Antifashiste e tij një aleat të sigurtë, të sigurt e të vendosur për të mbrojtur deri në fund aspiratat e popujve kundër agresorëve fashiste. Në Shqipëri, shkruan historiani gjerman Michail Shmidt Neke, "kishte një rezistencë të qartë ndaj pushtuesve, e cila duke e krahasuar me popullsinë e atëhershme të Shqipërisë prej 1.000.000 banorë mund të quhet një rezistencë jashtëzakonisht e madhe. Duhet theksuar qartë se shqiptarët kanë marrë pjesë shumë aktive në Koalicionin anti Hitlerian, duke kontribuar kështu jo vetëm në çlirimin e vendit të tyre, por edhe të popujve të tjerë". Edhe kur iniciativa strategjike ishte në dorën e gjermanëve dhe saktësia e goditjes se tyre mund të çonte në shfarosjen e forcave partizane "feniksi partizan mbijetonte", theksonte R. Hiberti, por dhe shumë nga misionarët e tjerë që vepruan gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Edhe se në mjaft situata repartet partizane ishin të zbatuar e të rreco-sur fryma e tyre luftarake ishte e shkëlqyer me shpirt luftarak e moral të lartë që mund të idealizohej si shpirt spartanë me shfaqjet e veta trimërore. Humbjet e kombit shqiptar llogariten mbi 34 mijë dëshmorë (28 mijë Shqipëria, 6200 në Kosovë e disa qindra nga shqiptarët e Maqedonisë e Çamërisë), mbi 15.000 të plagosur e të internuar në kampe. Vetëm në Itali bij dhe bija të Shqipërisë vuan dhe rezistuan në 98 burgje, ishuj e vende internimi. 50.000 me punë të detyruar, rreth 1/3 e fshatrave e qendrave të banuara e të blegtorisë u shkatërruan e u asgjësuan. Është rasti të theksojmë se kur flasim për Luftën Antifashiste e humbjet e shqiptarëve sigurisht duhet të kuptohet që Lufta Antifashiste nuk qe vetëm epopeja e luftëtarëve e të formacioneve partizane, se ajo hapet e shtrihet jo vetëm në formacionet ter-ritoriale apo Komandat e vendit, por edhe me kontributet e formacioneve jashtë frontit Nacionalçlirimtar, formacioneve nacionaliste në luftën kundër nazifashistëve, në rezistencën e guximshme të burgosurve e të internuarve nga fashistët italianë, në kampet e përqendrimit Gjerman, angazhimet e nënreparteve e të ushtarakëve të ushtrisë mbretërore në qëndresën antifashiste, bile dhe të pjesëtarëve nga Ushtria e rregullt të ri-ngritur nga okupatorët që dhanë ndihmesë në frontin e madh të Luftës kundër nazifashistëve në Luftën Italo-Greke e më pas.



Rivlerësim i domosdoshëm

Jemi të ndërgjegjshëm se edhe historia dhe çdo vepër-riktari e mendjes njerëzore jetojnë brenda kornizave të kohës. Por për gati gjysmë shekulli, siç dihet, nuk ishte gjithmonë e mundur të jetojmë intensivisht dinamika intelektuale të testuar nga kompleksiteti i problemeve të gjithanshme të ngjarjeve madhore siç ishte Lufta Antifashiste e popullit shqiptar. Jemi të ndërgjegjshëm gjithashtu se mjaft fakte humbasin në vrimat e zeza të historisë duke krijuar mistere e paradokse banale çka i shtyn në punë të thella studiuesit. Tani që ka kaluar një dekadë e gjysmë nga kolapsi i partisë shtet mendimi vjen natyrshëm se ka ardhur koha për një analizë serioze, jo partizane për t'u vënë në krye të detyrës së vështirë të rivlerësimit e ndryshimit të historisë. Gjithsesi, siç shprehet R. Luraghi, anëtarë i rezistencës Antifashiste i Luftës së Dytë Botërore, një nga personalitetet më të fuqishme të Historiografisë Botërore dhe mik i Shqipërisë është vështirë që brezi që bëri luftën nuk mundet, për motive të thella, të shkruaj historinë e atyre viteve mizore, e megjithatë, në një kah të mrekullueshëm. Kështu kronikat e parë për Luftën Antifashiste janë pjesëmarrës ose bashkëkohësit e saj të cilët ngarkesa emocionale dhe qëndrimet subjektive janë të pashmangshme. Më vonë u krijua një version zyrtar i Historisë së Luftës i ngritur mbi një monopol shtetëror të gjatë në kohë, version që është bërë ndoshta subjekti më i rrahur në diskutimet publike. "Injorimi i kujtesës ekzistuese të luftës dhe vënia në dukje e zbrazëtirave ose "njollave të bardha" në këtë kujtesë, shkruan Prof. Ana Lalaj, u përdorë për të mbështetur politikën e ditës" duke bërë që Historiografia e Luftës u gjet në kurthin e politizimeve të reja. Për fat të keq historiografia shkencore ndihet ende e goditur nga amatorizmi jo profesional. Kështu për hir të së vërtetës duhet thënë se p.sh deri vonë njihnim organizata e formacionet jashtë frontit NAÇ (Balli e Legaliteti) të modeluar dhe të etiketuar e anatemuar ashpërsisht nga kundërshtarët e tyre dhe kohët e fundit ato po prezantohen të ndryshëm në mënyrë apoteoziane nga idhujtarë të tyre. Tashmë Lufta e Ftohtë nuk është puna e një kujtimi dhe realitetet e fundit e pas Luftës së Ftohtë na bind se nuk jemi në fund të historisë. Dhe mesa duket do të duhet ende kohë që studiuesit të hyjnë në marrëveshje me të kaluarën e gatishmërinë dhe aftësinë për të pranuar një reflektim të pa kushtëzuar, qoftë të asaj pjese të së kaluarës që dhemb. Në këtë kah për sa i përket të rinjve, të pak-tën e atyre që do ti kushtohen historisë së luftës, si

zgjedhje në jetë, nuk do ta kenë të lehtë, sepse përpara se të zhyten në një punë kërkimore të vërtetë e tërë profesionalizëm ata duhet të boshatisin terrenin nga të gjitha karakatinat e pseudo-historisë që janë depozituar në shumë shtresa. Ky pastrim duhet të jetë i gjatë dhe ka mundësi që shumë nga ata që luftuan me armë në dorë të mos ta shohin rezultatit, por me siguri më në fund do të hartohet një histori e kësaj ngjarje epike dhe tragjike siç qe Lufta Antifashiste.

E zhveshur më në fund nga zbukurimet, Lufta Antifashiste do të shfaqet në sytë e brezave të ardhshëm me madhështinë e saj, me dritëhijet e saj, me heronjtë dhe martirët e saj. Vetëm atëherë do ta kuptojmë se sa e madhe ka qenë, tmerrësisht e madhe, çfarë burra e gra ka pasur dhe çfarë kontributi të jashtëzakonshëm i ka dhënë atdheut dhe do të përkulen para saj me respekt, gati-gati me frikë sepse do ta kuptojnë misionin ose mësimin mbinjerëzor. Disa vite më parë një shkrim të një reviste amerikane duke përshëndetur brezin që kishte luftuar në Luftën e Dytë Botërore dhe që tani ishte në pension midis të tjerave shkruante vargjet e një kënge lufte me popullaritet në Britaninë e Madhe që thoshte "dhe do të kthehen pëllumbat në fluturim, mbi shkëmbinjtë e bardhë të Doverit, nesër kur bota do të jetë e lirë. Sot bota është çdo çast më e lirë se sa kurrë më parë, dhe merita i përket, në pjesën më të madhe, këtij brezi fantastik të mrekullueshëm, luftëtarët e Luftës së Dytë Botërore. Por pëllumbeshat nuk janë kthyer akoma, luftëtarët nuk kanë mundur ti sjellin ato. Kjo do të jetë detyrë e fëmijëve të tyre". Mesazhi është tejet i qartë. Kuptohet parë në retrospektivë, jo gjithçka është zgjidhur gjithmonë drejtë. Por në këndvështrimin njerëzor ne nuk do i lejojmë vetes të ishim qortues të gjyshërve e prindërve tanë. Jemi koshientë sepse ne nuk jemi veçse gjykatës të dobët të vështirësive dhe përpjekjeve mbi njerëzore që bën luftëtarët antifashistë. Dhe po të perifrasonim Kennanin, duhet të kënaqemi duke kujtuar se gjatë vendimeve të tyre ata u ndodhën përballë problemesh e vështirësish për mbarëvajtjen e Kombit. Se këto probleme janë ende përpara nesh dhe që akoma kërkojmë përgjigje. Dhe nëse njerëzit e atyre kohëve mund të pranojnë se nuk mund t'i finalizojnë objektivat, brezi ynë dhe më të rinjtë nuk mundet ta kemi këtë luks.

Situata të reja, koalicionë të reja

Fashizmi si lëvizje apo formë qeverisje thellësisht reaksionare nuk i përket vetëm së kaluarës. Sepse



“barku që nxori kafshën e përbindshme, - do të shkruante poeti e dramaturgu gjerman B. Broht, - mund të pjellë akoma”. Është fakt se për fat të keq, këto paralajmërime për rrezikshmërinë e fenomeneve që çuan drejt shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore i shohim të përsëriten edhe sot para syve tanë, në rezultatet jo të dëshiruara “të përsëritjes së Historisë” në Ballkan, në disa pjesë të ish Bashkimit Sovjetik dhe në pika të tjera të planetit. Po kështu dihet se sulmet terroriste të 11 Shtatorit në mënyrë të pa diskutueshme krijuan një erë të re në çështjet ndërkombëtare të sigurisë. Atentatit i 11 Shtatorit ka ndryshuar konfigurimin Gjeopolitik të Botes. “Për herë të parë në Shqipëri fuqitë më të rëndësishme të botës janë në vija të përgjithshme dakord për një operacion në shkallë të gjerë”. Bashkësia botërore i doli përballë kërcënimit të kryer nga terrorizmi botëror me një koalicion mbarë botëror të pashembullt, duke përdorur çdo mjet të pushtetit kombëtar dhe ndërkombëtar, diplomacinë, forcën e ligjit dhe të rendit, agjencitë e zbulimit, hetimet financiare, veprime luftarake dhe ndihmën humanitare. Larmia dhe natyre elastike e këtij koalicioni të pashembullt përbën një nga pikat e tij më të forta. “Koalicioni i kryesuar nga SHBA është i paprecedentë”, theksonte Bush. Në këtë luftë misioni përcaktoi koalicionin e jo anasjelltas siç ndodhi në koalicionin antifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sot më tepër se kurrë asnjë vend nuk mund të përballojë sfidat e kohës i vetëm. Me infrastrukturën jashtëzakonisht të ekspozuar ndaj kërcënimeve, me kufij porozë dhe me praninë e grupeve ekstremiste që lëvizin lirisht brenda dhe midis shteteve të një Europe në zgjerim, apo të një bote në integrim etj., nevoja për një kuptim më largpamës të aleancave apo përkthyer në gjuhën moderne të sigurisë bashkëpunuese është e dukshme. Dhe ky mesazh vjen gjithmonë i freskët që nga Lufta e Dytë Botërore e sidomos nga pesha dhe rëndësia e koalicionit antifashist.

“Pas konflikteve të mëdha njerëzore, shkruan historiani i Kembrixhit, Herbert Baterfield, ka një periudhë tmerrësisht të vështirë që shtrihet mu në zemër të Historisë. Bashkëkohësit nuk pranuan të njihnin vërtetësinë e saj, kështu që ç’dimë për të vjen vetëm prej analiza të mëvonshme. Vetëm me progresin e shkencës historike në një subjekt të veçantë, u bë e mundur që njerëzit të kuptojnë se pas naivitetit njerëzor ka një nyje të tmerrshme që duhet zgjidhur”. Sistemi i sigurisë bashkëpunuese është baza për realizimin e një të ardhmeje sa më paqësore e



humane. Ata që kapen pas koncepteve të vjetra të pushtetit do të sakrifikojnë popujt dhe kombet e tyre të jetojnë gabimet e shekullit që lamë pas (Shek XX). Ata që e kuptojnë se pushtetit i vërtetë i shekullit që jetojmë (XXI) do të vijë nëpërmjet përpjekjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar të vërtetë, do të udhëheqin vendet e tyre drejt një shekulli të ri të paqes e të prosperitetit dhe kur flasim për sistem sigurie bashkëpunuese nënkupton veç të tjerash dhe aleanca e koalicione efektive, të parapërgatitura për përballimin e çdo kërcënimi e që doemos mbajnë parasysht dhe përvojën e koalicionit anti Hitlerian. Dhe për hir të së vërtetës duhet të mos harrojmë se “zhvillimet pozitive e të suksesshme të koalicionit Antifashist morën formë vetëm nën goditjet e dhimbshme të dështimeve ushtarake, fushatave dhe jo para shpërthimit të armiqësisë”. Është e qartë se politika e ndërtuar sipas koncepteve nga pista e forcës është një politikë e rrezikshme e cila mund të çojë lehtë në luftë. Për sa i përket popullit shqiptar, i cili mori pjesë aktive dhe e pagoi me kontribut të lartë, gjak e sakrificë në Luftën e Madhe Antifashiste, i kanë vlejtur mësimet e dhura nga përvoja e Luftës së Dytë Botërore deri në ditët tona që testohet edhe me rreshtimin e kontributin në koalicionin anti-terror etj. 9 maj 1945 sjell të freskët mesazhin: Popujt janë kundër forcave të errëta të shoqërisë, kundër luftës që imponojnë ato, janë për paqe brenda së cilës çdo popull ruan dinjitetin, pavarësinë e tij. Edhe atëherë kur njerëzimi nuk ka qenë në gjendje që të pengojë zhvillimin e ngjarjeve me pasojë negative, (si p.sh Lufta e Dytë Botërore), rezultati historike ka qenë me popujt të cilët kanë dalë fitimtarë. Në këtë kuptim në se shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore është shprehje e hapur e forcave fashiste, fundi i saj është triumf i forcave demokratike liridashëse.

Është e natyrshme, se për koalicionin e AF e fitoren mbi fashizmin, për këtë ngjarje me përmasa ndërkombëtare as që mendohet të jepet e plotë me tërë dramacitetin e tyre në këto pak rreshta. Atë se kanë rrokur dot mijëra vëltime të tërë. Por asnjëherë nuk mund të zbehet homazhi për popullin që bën sakrificat të shumta gjatë viteve të luftës dhe për ato miliona njerëz që dhanë jetën për arritjen e fitores përfundimtare mbi nazi-fashizmin. Në qoftë se, jehona e zërit të tyre, zëri i atyre që u masakruan dhe u vranë nga fashizmi, do të shuhej, ne do të merrnim fund, paralajmëron poeti francez Pol Elyar.



Kontributi i Shqipërisë në fitoren e koalicionit antifashist botëror

Ndihmesa e popullit shqiptar në krah të Aleatëve të Mëdhenj për fitoren mbi fashizmin dhe kostoja që ai pagoi për këtë është tepër e ndjeshme. Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Frontit NÇ, radhitjen e tij në krah të Aleatëve të Mëdhenj nuk e pa thjesht si një aderim apo solidarizim e aq më pak për ta pasur si një kartë për ta tundur në përfundim të luftës. Në të kundërt, besnik i traditave të të parëve të vetë, ai këtë renditje e shikonte dhe e zbatoi, pa as më të voglin hezitim, si një detyrim e angazhim moral e atdhetar për të renditur në frontin e përbashkët gjithë potencialet morale, njerëzore, materiale e luftarake. Populli shqiptar në saj të ndihmesës së çmuar në shkallë ndërkombëtare, arriti me dinjitet ta radhis veten në ballin e qëndresës antifashiste e në krahë të fitimtarëve. Ky pozicionim i prerë antifashist ishte njëherazi edhe një ndihmesë në ruajtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar të pas luftës, të rrezikuar nga lakmitë e shteteve shoviniste fqinje. Merita është e padiskutueshme e organeve dhe personaliteteve politike e ushtarake që udhëhoqën LANÇ-in, të cilët ditën të vendosin e të ruanin raporte të drejta në mes të faktorit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar në këtë luftë për jetë a vdekje. Kjo luftë dhe sakrificat mbinjerëzore që bënë brezat e shkuar na japin sot krenarinë kur dëgjojmë që vendi jonë radhitet ndër të parët dhe përfaqësuesit e tij që dekorohen nga të huajt për merita në këtë luftë. Populli shqiptar përulet me respekt ndaj gjithë atyre që bënë LANÇ-in dhe brezave që përballuan me dinjitet peshën e rëndë të saj. Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar në shkallë ndërkombëtare ishte pjesë përbërëse e luftës botërore antifashiste. Me këtë luftë heroike populli shqiptar i tregoi botës se Shqipëria e vërtetë nuk ishte ajo e një grushti tradhtarë që e kishin shpallur "aleate të Boshtit", por ajo që populli kryengritës, me Frontin NÇ në krye, e kishte vënë veten në radhët e pjesëtarëve më aktivë të popujve dhe shteteve të koalicionit të madh antifashist. Populli shqiptar me afro 1 milion, ngriti ushtrinë çlirimtare me qindra e mijë luftëtarë, ai angazhoi në luftë 15 divizione italiane e gjermane

dhe u shkaktoi atyre mijëra të vrarë, të plagosur dhe dëme të shumta materiale. Populli kryengritës shqiptar dërgoi dhe përtej kufijve shtetërorë mjaft luftëtarë të Ushtrisë së tij Nacionalçlirimtare, të cilët luftuan me vetëmohim për çlirimin e popujve të Jugosllavisë dhe të vëllezërve shqiptarë të Kosovës. Lufta e Dytë Botërore, nga shtrirja, pjesëmarrja e forcave dhe e mjeteve luftarake, dëmet në njerëz, në mjete e të mira materiale, ishte më e madhja dhe më shkatërrimtarja në historinë e njerëzimit. Shqipëria, u bë viktimja e parë në Evropë, pavarësisht se bota në atë kohë thuajse e kaloi në heshtje, e pushtuar nga forcat e fashizmit italian më 7 prill 1939. Portet shqiptare Durrësi, Shëngjini, Vlora dhe Saranda, hodhën pushkët e para, kur politika evropiane tkurrej nga pesha e trysnisë nazifashiste, dhe dhanë sinjalin e qëndresës antifashiste evropiane. Krijimi i çetave të para atdhetare, si e Myslim Pezës,



përbën jo thjesht krenari, por dhe ndihmesë në fillimet e qëndresës antifashiste evropiane. Mesazhi që dha Shqipëria në ditën dhe në vitet e para të pushtimit, ishte lufta pa kompromis me pushtuesit nazifashistë. Në këtë mënyrë populli shqiptar, po e rendiste veten në krah të forcave antifashiste botërore. Kjo nuk ishte e lehtë dhe nuk erdhi vetvetiu e njëherazi. Ajo ishte produkt, nga njëra anë i zgjerimit dhe i zhvillimit gradual, gjithnjë në rritje i qëndresës e luftës së armatosur të popullit shqiptar dhe, nga ana tjetër, rezultat i një sërë aktesh politike të organeve të larta drejtuese të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Shqipëria nuk trashëgoi në pikëpamje të forcës ushtarake, asgjë nga ish ushtria mbretërore. Fronti Nacionalçlirimtar dhe Partia Komuniste shqiptare si e vetmja forcë politike aktive në luftë kundër fashizmit, ju desh që gjithçka ta fillonin nga elementet më fillestar të organizimit e të veprimit ushtarak. Në UNÇSH të Shqipërisë ishin rreth 70.000 luftëtarë të përfshirë në 24 brigada, 8 divizione dhe 3 korparmata. Konferenca historike e Bujanit i dha zhvillim Lëvizjes NÇ në Kosovë, ku u krijuan 9 brigada partizane me rreth 53.000 luftëtarë. Në luftime e operacione të ndryshme në Shqipëri u vranë 28.000 dëshmorë, krahas rreth 20.000 qytetarëve të masakruar, vranë e gjymtuar nga pushtuesit fashist e nazist. UNÇSH-ja e plotësoi më së miri misionin që mori mbi vete duke çliruar vendin pa qenë e nevojshme që në truallin e saj të futeshin formacione ushtarake të forcave aleate. Kjo përbën, në pamjen luftarake, ndihmesën e drejtpërdrejtë të popullit shqiptar në kuadër të Koalicionit të Madh Botëror Antifashist. Shqipëria mbajti kështu një peshë të rëndë në raport me popullsinë. Luftën e tij kundër pushtuesit populli shqiptar nuk e shikonte të shkëputur nga fati e lufta e popujve të tjerë të robëruar dhe në tërësi të Bllokut të Madh Antifashist Botëror. Viti 1942, veçanërisht gjysma e dytë e tij, shënuan disa ngjarje e akte që e afronin atë gjithmonë e më tepër me Aleatët e Mëdhenj. Akti i parë dhe shumë domethënë, ishte padyshim Rezolucioni i Konferencës së Pezës. Në mënyrë të logjikshme, Konferenca, me mesazhet që përcolli por dhe me rezultatet që po bënte në zgjerimin e luftës antifashiste, tërhoqi edhe vëmendjen e Aleatëve të Mëdhenj. Britania e Madhe, BRSS dhe SHBA, më 17 e 18 dhjetor 1942, me deklarata të veçanta mbështetën fuqishëm LANÇ-in, duke e njohur atë publikisht si aleat në luftën e përbashkët. Një akt tjetër, krahas krijimit e zgjerimit të UNÇSH dhe fuqizimit të luftës së armatosur, për nga vendimet që mori për vijimin e luftës, por edhe tepër domethënë i renditjes së Shqipërisë në krah të Aleatëve të Mëdhenj, ishte edhe mbajtja e Kongresit të Përmetit më 24 maj 1944. Punimet e tij u zhvilluan duke mbajtur në sfond, krahas flamurit kombëtar e portreteve të atdhetarëve të shquar rilindas, edhe flamujt e tre Aleatëve të Mëdhenj dhe fotografitë



e Rusveltit, Stalinit e Çerçillit. E njëjta frymë e këmbënguljes në krah të Aleatëve të Mëdhenj u përshkua edhe në dokumentet e aprovuara në Konferencën e Dytë të Këshillit Antifashist, mbajtur në Tetor 1944 në qytetin e Beratit. Pranë Shtabit e Komandës së Përgjithshme, në vijim të vlerësimit të tyre të angazhimit pa kompromis në Luftën Antifashiste e në krah të Aleatëve, në vitet 1943-1944 erdhën edhe përfaqësues ushtarakë të komandave ushtarake britanike, sovjetike dhe amerikane, duke dërguar edhe ne, në Shtabin Aleat të Mesdheut, përfaqësinë tonë. Shqipëria, besnike e angazhimit të saj në luftën e përbashkët, dërgoi formacionet e veta luftarake për çlirimin e trojeve shqiptare jashtë kufijve tokësorë si në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi e madje edhe deri në Bosnjën Jugore. Kështu SHP dhe Komanda e Përgjithshme e UNÇSH kreu me nder misionin e vet në luftën çlirimtare antifashiste jo vetëm ndaj popullit të vet por edhe ndaj aleatëve dhe popujve fqinjë.

Riorientimi i Bundeswehr-it

Vështrim i përgjithshëm mbi riorientimin e Bundeswehr-it, sipas kontratës së koalicionit të bashkëqeverisjes, nëntor 2013

Përgatiti: Kap. Rang I-rë **ARBEN DEMOLLARI**
Atashe Ushtarak i RSH në RF të Gjermanisë

Qeveria e RF të Gjermanisë kërkon të ndërtojë një mënyrë aktive rendin global. Lidhur me këtë çështje ajo orientohet nga interesat dhe vlerat e vendit. Gjermania zotohet për liri, siguri, paqe në të gjithë botën, për një rregull botëror të drejtë, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për zbatimin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut si dhe zhvillim të kombeve e luftë ndaj varfërisë. Qeveria e RFGJ është e gatshme, sa herë priten kontribute prej saj për zgjidhjen e krisave dhe konflikteve. Lidhur me këtë çështje, parësore për të janë mjetet e diplomacisë, të rregullimit paqësor të konflikteve dhe bashkëpunimit për zhvillim, si dhe besueshmëria dhe besnikëria në aleancë.

Forcimi i partneritetit transatlantik dhe NATO

Bashkëpunimi transatlantik është i një rëndësie të veçantë si për Evropën ashtu edhe për Amerikën e

veriut. Ky bashkëpunim bazohet në vlera dhe interesa të përbashkëta dhe prandaj është edhe sot çelësi i lirisë, sigurisë dhe mirëqenies për të gjithë. Aty ku më parë u vu në pikëpyetje besnikëria, duhen bërë përpjekje për ta rforcuar atë. Për këtë RFGJ pret një angazhim të dukshëm dhe masa të nevojshme nga ana e SHBA. RFGJ kërkon të përcaktojë qartë rregullat, që vlejnjë për komunikimin ndërmjet partnerëve, dhe synon marrëveshje të verifikueshme dhe të besueshme për të mbrojtur sferën private të qytetarëve tanë. Marrëveshja e planifikuar me SHBA lidhur me tregtinë e lirë është një ndër projektet qendrore për thellimin e marrëdhënieve transatlantike. RFGJ kërkon, që negociatat të shkojnë drejt përfundimit, pa diskutuar në kontrate mbi kontrollin parlamentar dhe mbrojtjen gjyqësore. RFGJ i kushton rendësi sigurisë së standardit të mbrojtjes në BE, në mënyrë të veçantë në fushën e mbrojtjes së të dhënave, standardeve europiane për mjedisin, produktet ushqimore, standardet sociale në përgjithësi si dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, të kulturës dhe mediave. RFGJ beson te NATO dhe tek Koncepti i ri Strategjik i saj. Aleanca transatlantike është dhe do të mbetet themeli qendror i politikës së mbrojtjes dhe sigurisë për sa i përket rreziqeve dhe kërcënimeve të reja të një bote globaliste. Ajo është organizata, ku partnerët diskutojnë dhe koordinojnë pikëpamjet e tyre strategjike lidhur me politikën e sigurisë. RFGJ vepron në aleancë së bashku aktivisht dhe zotohet njëkohësisht në të njëjtën mënyrë që marrëdhëniet ndërmjet Amerikës së veriut dhe Evropës të jenë të qëndrueshme dhe të thellohen më tej. Gjermania do të vazhdojë edhe më tej të japë kontributin e përshtatshëm dhe të besueshëm për aleancën. Sëbashku me partnerët e tjerë të NATO-s do të verë në zbatim në mënyrë të vazhdueshme vendimet e Chicagos për riorientimin e aleancës. RFGJ mbështet bashkëpunimin e mbrojtjes mbi bazën e iniciativës Smart-Defense për të planifikuar dhe siguruar bashkërisht aftësitë ushtarake si dhe për të mbajtur kooperimin e ndërmjetëm në aleancë. Gjermania është e gatshme për të dhënë kontributin e saj së bashku me partnerë të tjerë në lidhje me prurjen e aftësive për aleancën.





Dialog të hapur dhe bashkëpunim më të zgjeruar me Rusinë

Gjermania dhe Rusia, në sajë të një historie të vazhdueshme janë shumë të lidhura me njëra-tjetrën. Rusia është fqinji më i madh e i rëndësishëm, i Bashkimit Europian. Një Rusi moderne, e fuqishme ekonomikisht dhe demokratike është në interesat e Gjermanisë dhe Evropës. RFGJ kërkon ta zgjerojë ortakërinë e modernizuar edhe në aspekte të tjera, me qëllim që të ketë përparime shoqërore, politike dhe ekonomike. RFGJ ka përshëndetur dhe mbështetur përpjekjet e shpeshta për një zgjerim dhe thellim të lidhjeve në nivelet shtetërore dhe sociale, gjithashtu ka nxitur përparimin e mëtejshëm të dialogut të Petersburgut. Përtej kësaj, RFGJ ka kërkuar të sjellë në jetë forma të reja të dialogut social me Rusinë dhe të intensifikojë kontaktet dypalëshe për të përfaqësuar shtresën e re të mesme të shoqërisë civile. Rusia është e detyruar të ketë standarde në drejtësi shtetërore dhe demokraci, për të cilat Rusia është e detyruar edhe në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Çarmatimi dhe kontrolli i armëve

Politika për çarmatimin dhe kontrollin e armëve është një element shumë i rëndësishëm për politikën e jashtme dhe të brendshme gjermane. Çarmatimi, kontrolli dhe mospërhapja e armëve kanë një rol të rëndësishëm për paqen, sigurinë dhe stabilitetin. RFGJ do të ndihmojë për çarmatimin dhe kontrollin e armëve të përgjithshme në të gjithë botën, jo vetëm për ato konvencionale, por edhe për ato të shkatërrimit në masë. Së bashku me partnerët e NATO-s, ajo ka si qëllim që të pastrojë botën nga armët bërthamore dhe deri atëherë edhe për ta zvogëluar rolin që kanë këto armë. Për sa kohë armët bërthamore përdoren si një mjet frikësimi nga koncepti strategjik i NATO-s, Gjermania do ketë interesa të marrë pjesë në diskutimet strategjike dhe proceset e planifikimit. RFGJ punon ndërkombëtarisht për zbatimin e plotë të marrëveshjes së OKB-së për armët e vogla dhe

ndihmon gjithashtu edhe në zbatimin e përshtatshëm të mekanizmit të kontrollit kombëtar, gjithashtu, ajo nxit energjikisht zbatimin ndërkombëtar të Traktatit të Tregtisë të Armëve. Gjermania mbështet marrëveshjet rajonale, të zonave pa armë të shkatërrimit në masë. Me një qëndrim të përbashkët të BE-së do të kontribuojë për suksesin e Konferencës së ardhshme të Rishikimit të Traktatit të Mospërhapjes në vitin 2015.

OKB, dialogë globale dhe ortakëri strategjike

Kombet e Bashkuara kane një rol kyç në ruajtjen e paqes dhe zgjidhjen e probleme globale. Nëpërmje iniciativave të reja, të cilat RFGJ i vendos me partnerët e saj europianë, ajo jep kontributin saj për rinovimin dhe përparimin e strukturave të OKB-së, duke synuar arritjen e një reforme për përmirësimin e shkallës së sigurisë. Gjermania është e gatshme të marrë më shumë përgjegjësi në nivelin e OKB dhe me marrjen e përhershme në Këshillin e Sigurisë. Për vendosjen e pozicioneve të drejtimit në OKB, RFGJ ka një koncept efektiv personal. Për këtë, do të mbikëqyrë edhe koordinimin ndër-institucional të OKB dhe do të forcojë qendrën e OKB në Bonn. RFGJ zhvillon në vazhdimësi përkushtimin për paqe dhe siguri edhe jashtë Europës nëpërmjet partneriteteve strategjike. Në 2015 Gjermania do të marrë përsëri Presidencën e G8. Për këtë ajo synon të vazhdojë bashkëpunimet me partnerët e G20.

Afganistan

Pas më shumë se 10 vite, angazhimi i RFGJ-së për politikën e sigurisë në Afganistan do të ndryshojë. Me një angazhim ndër-institucional, RFGJ do të përpiqet për një të ardhme të qëndrueshme për Afganistanin. Trupat ushtarake ISAF në Afganistan do të tërhiqen deri në fund të 2014-s dhe në këtë kohë duhet të jetë arritur aftësia për siguri. Forcat vendase afgane, të cilat punuan për RFGJ dhe rrezikuan sigurinë dhe jetën e tyre sipas kushteve të shërbimit, do të marrin një

ftesë për tu shpërngulur bashkë me familjet e tyre në Gjermani.

Orientimi kryesor i Bundeswehr-it

Bundeswehri ka provuar të jetë një ushtri, në demokraci dhe për demokracinë. Modeli i zhvillimit të lidërshiptit dhe i ushtarakut si qytetar në uniformë do të vazhdojë të shërbejë në Forcat e Armatosura dhe në misionet e Bundeswehr-it për paqen dhe lirinë në botë. Bundeswehr është një ushtri në mision. Riorientimi i ri do të jetë siguria politike e shekullit të 21-të. Kjo është sfida e së ardhmes. Bundeswehri do të vazhdojë këtë riorientim strategjik dhe do ta çojë drejt suksesit rrugën e nisur. Implementimi përfshin procese të konsiderueshme rregulluese për tërë Forcat e Armatosura. Anëtarët e Forcave të Armatosura dhe familjet e tyre kanë nevojë për siguri planifikimi në të ardhmen dhe, edhe në të ardhmen, Bundeswehri do t'i kushtojë vëmendje të rreptë raportit kosto-efektivitet, funksionalitetit e atraktivitetit. Personeli i planifikuar deri në 185.000 ushtarakë përmbush nevojat e një Bundeswehr-i efikas në plotësimin e detyrave dhe misionit të tij, si dhe forcimin e rolit të Gjermanisë në raport me partnerët e saj evropianë. Për sa i përket punonjësve civil, vlerësimi i tyre bëhet në bazë të detyrave që ata kryejnë. Nuk ka perspektive për një reduktim të numrit të personelit të Bundeswehr-it.

Atraktiviteti

Për Gjermaninë, është e rëndësishme që shërbimi në Bundeswehr të mbetet tërheqës, të sigurohet një atraktiviteti ofensiv. Bundeswehri është për një familje miqësore, veçanërisht për kujdesin e fëmijëve dhe nëse është e nevojshme edhe në konsultim me autoritetet lokale. Sa i përket numrit të lartë të personave që udhëtojnë çdo ditë për në punë (që shërbejnë larg qendrave të banimit), Bundeswehri synon e përpiqet që t'u gjejë një vend pune sa më afër familjeve të tyre. Për më tepër, synon të krijojë mundësitë, për të zgjedhur midis dhënies së kompensimit për ata që jetojnë larg familjeve, ose të rimbursimit të shpenzimeve për një zhvendosje të përhershme. Përshtatja në përputhje me rrethanat e bazën ligjore që rregullon marrëdhëniet në Ushtrinë gjermane midis oficerëve dhe nënoficerëve dhe çdo gjë që ka lidhje me jetën ushtarake, mbetet një synim i gjithëhershëm. Profesionit i ushtarakut dhe profesionalizmi i tij në detyra të ndryshme të jetë synohet që të jetë sa më i harmonizuar me familjen. Shfuqizimi i kufizimeve mbi të ardhurat shtesë të ushtarëve në pension, është provë e përkujdesjes.

Ushtaraku dhe shoqëria

Aktualisht, po punohet për të zgjeruar të kuptuarit e specifikave të profesionit të ushtarakut duke siguruar kështu njohje të gjerë për shërbimin në Forcat e Armatosura. Betimet (ceremonitë) në publik janë një shenjë që tregon sa i vlerësuar është Bundeswehri në shoqërinë demokratike. Koalicioni mbështet dialogun e vazhdueshëm të Bundeswehr-it në dhe me shoqërinë. Shërbimi i ri ushtarak vullnetar, i ka provuar vetë



avantazhet e tij. Koha aktuale në shërbimin vullnetar, e personave që e kryejnë këtë shërbim, do të rishikohet dhe do të përshtatet nëse është e nevojshme. Koalicioni e njeh vlerën e forcës rezerviste për përmbushjen e detyrave të Bundeswehr-it dhe do të jetë një urë lidhëse midis Bundeswehr-it dhe shoqërisë. Forcat e sigurisë rajonale dhe mbështetëse do të pajisen në mënyrë të përshtatshme për të realizuar detyrat e tyre në fushën e bashkëpunimit civil-ushtarak. Për të rritur atraktivitetin e rezervistëve, shqyrtohet përshtatja dhe thjeshtimi i shpërblimit si p.sh. sigurimi i ligjit të pensionit. Koalicioni mbështet në mënyrë specifike bashkëpunimin e rezervistëve me shërbimi civil. Për



këtë, sektori publik luan një rol model.

Të përgatitur për misionet e së ardhmes

Bundeswehri do të jetë edhe në të ardhmen i pranishëm në misione jashtë Gjermanisë. Kjo kërkon një spektër të gjerë të aftësive ushtarake. Për aq sa është e arsyeshme dhe e mundshme, do të mbështetet përdorimi i përbashkët i aftësive ushtarake kombëtare në kuadër të BE (pooling and sharing), si dhe për një shpërndarje më të madhe të detyrave. Kjo vlen edhe për aktivitetet përkatëse të NATO-s (në përputhje me konceptin 'smart defence'). Qasja se si kjo mund të jetë, është partneriteti ose koncepti në kuadër të bash-

këpunimit ndërmjet shteteve, ku shtetet ndihmojnë njeri-tjetrin me përkrahje reciproke. Bundeswehri do të mbetet një ushtri parlamentare edhe në të ardhmen. Përfshirja e Parlamentit në vendimmarrjen për misionet e Bundeswehrit nuk është një dobësi e Gjermanisë, por një forcë e saj. Koalicioni siguron përfshirjen e Parlamentit në vendimin për misionet e ushtarëve gjermanë edhe në kuadër të bashkëpunimit dhe ndarjes së punës me partnerët. Një pjesëmarrje në rritje e ushtarëve gjermanë në strukturat e integruara dhe shtabet në nivel të NATO-s dhe BE-së duhet të jetë në përputhje me kërkesat e miratimit parlamentar. Kjo është arsyeja pse ne duam të përdorim një Komision, i cili brenda një viti do të provojë, të drejtat parlamentare që mund të sigurohen si në rrugën e integritit gradual të Aleancës edhe me gjithë larminë e detyrave. Operacionet e Komandës së Forcave Speciale (KFS) janë të lidhura gjithmonë me një rrezik të lartë për forcat tona të angazhuara në mision dhe janë tepër konfidenciale. Ne do të informojmë Parlamentin për misionet e KFS në mënyrë të sigurt dhe jo si për misionet e tjera normale.

Pajisjet, prokurimi dhe përdorimi

Ushtarët kanë nevojë për pajisjet me të mira. Në këtë mënyrë siguria e tyre është në qendër të vëmendjes. Bundeswehr kryen ato blerje që i nevojiten dhe jo ato që i ofrohen. Pajisjet ushtarakë, të porositura në bazë të kontratave, në kohë dhe në përputhje me çmimin dhe cilësinë e rënë dakord, janë të mirëpritura. Marrëdhëniet kontraktuale me industrinë duhet të jenë të qarta dhe të dallueshme. Përvoja e fundit me pajisjet e mëdha tregojnë se monitorimi dhe kontrolli i projekteve duhet të përmirësohet në të gjitha nivelet. Riorganizimi i cili fillon me ristrukturimin e procesit të prokurimit duhet të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme. Informimi i Komisionit të Mbrojtjes dhe Buxhetit të Parlamentit Gjerman për gjendjen përkatëse të zhvillimit dhe prokurimit synohet të përmirësohet. Gjermania ka një interes themelor në një Industri ushtarake, e cila është inovative, efikase dhe konkurruese. Koalicioni është i angazhuar për ruajtjen e teknologjive të zgjedhura kyçe dhe aftësive industriale, sidomos për kompanitë e mesme si dhe mbështet rritjen e bashkëpunimit të armatimit evropian dhe euro-atlantik, i cili zbaton programe të përbashkëta për armatimin dhe prokurimin me të njëjtat standarde për të gjitha shtetet. Këtu luan një rol kyç Agjencia Europiane e Mbrojtjes. Një kusht për përmirësimin e bashkëpunimit ushtarak BE dhe NATO janë standardet e njëjta për certifikimin dhe pajisjen me leje të pajisjeve ushtarake. Kjo vlen për më tepër për aviacionin ushtarak. Forcat e Armatosura Gjermane do të jenë edhe në të ardhmen të varura nga aftësi të tilla. Koalicioni qeverisës do të çojë përpara zhvillimin evropian të mjeteve ajrore luftarake pa armatim. Europës i nevojitet me shpejtësi një model rregullator i përbashkët për lejimin dhe marrjen pjesë në trafikun ajror evropian. Koalicioni do të i zhvillojë edhe më tej iniciativat në këtë fushë.



Kronologjia e krizës së Ukrainës

SIGURIA

MIMOZA GOLIKJA

Ngjarjet kryesore dhe protestat antiqeveritare ukrainase kanë një vëmendje të posaçme ndërkombëtare. Që prej largimit të presidentit Viktor Janukoviç nëpërmjet protestave vdekjeprurëse kundër qeverisë, Ukraina ka bërë thirrje për zgjedhje të reja presidenciale më 25 maj. Ky veprim u kundërshtua nga administrata në Krime që votoi me shumicë dërrmuese për t'u bashkuar me Rusinë në një referendum që konsiderohet i paligjshëm nga SHBA dhe BE, por të mirëpritur nga Rusia. Qeveria në Kiev vazhdon të

theksojë nevojën për një Ukrainë të bashkuar, dhe udhëheqësit e botës të përpiqen për të shmangur konfliktin ushtarak. Më poshtë po sjellim disa prej ngjarjeve që kanë çuar në situatën aktuale.

21 nëntor- Janukoviç shpall braktisjen e një marrëveshje tregtare me BE-në, duke kërkuar lidhje më të ngushta me Moskën.

30 nëntor- Rritet mbështetja publike për protestuesit antiqeveritarë pro BE-së, imazhet e tyre të gjakosur nga dhuna policore përhapen në internet dhe në media.

1 dhjetor- Rreth 300.000 persona protestojnë në Sheshin e Pavarësisë së Kievit. Hall City merret nga aktivistët.

17 dhjetor- Presidenti rus Vladimir Putin njofton planet për të blerë 15bn \$, në obligacionet e qeverisë ukrainase dhe një ulje në koston e gazit natyror të Rusisë për Ukrainën.

16 Janar- Ligjet antiprotetë kalohen shpejt dhe dënohen si "drakoniane".

22 Janar- Dy protestues të vdekur pasi u goditën me municion të vërtetë. Një i tretë vdes pasi rrëzohet gjatë konfrontimit me policinë.

28 Janar- Mykola Azarov jep dorëheqjen si kryeministër i Ukrai-

nës dhe parlamenti shfuqizon ligjet anti protestë.

29 Janar- Kalohet një projekt-ligj, duke premtuar amnisti për protestuesit e arrestuar në qoftë se braktisen ndërtesat e sekuestruara qeveritare.

31 Janar- Aktivisti i opozitës Dmytro Bulatov gjendet jashtë Kievit, pasi u burgos dhe u torturua për tetë ditë, me sa duket në duart e një grupi pro rus.

16 shkurt- Aktivistët e opozitës i japin fund okupimit të City Hall në Kiev. Në këmbim janë liruar 234 protestues të burgosur.

18 shkurt- Përleshjet e rrugës lënë të paktën rreth 18 të vdekur dhe rreth njëqind të plagosur. Dhuna filon kur protestuesit sulmojnë linjat e policisë pranë sallës së parlamentit në miratimin e reformës kushtetuese për të kufizuar pushtetet presidenciale. Protestuesit marrin përsëri ndërtesat qeveritare.

20 shkurt- Kievi sheh ditën e vet më të keqe të dhunës për gati 70 vjet. Të paktën 88 njerëz janë vrarë në 48 orë. Pamjet tregojnë nga çatitë qeveritare snajperë dhe të shtënat në drejtim të protestuesve.

21 shkurt- Udhëheqësit e protestës,

Në reagimin e tij të parë publik ndaj krizës në Ukrainë, Putin thotë se “vendi i tij ka të drejtë të përdorë të gjitha mjetet për të mbrojtur qytetarët e saj në Ukrainë lindore”. Të shtëna paralajmëruese, forcat ruse hapin zjarr mbi ushtarë të paarmatosur të Ukrainës, në marshimin drejt një baze ajrore në Sevastopol.



opozita politike dhe Janukoviç bien dakord për të formuar një qeveri të re dhe të zhvillojnë zgjedhje të parakohshme. Fuqitë e Janukoviç janë tkurrur. Parlamenti voton për të liruar nga burgu ish-kryeministren Julia Timoshenko. Janukoviç ikën nga Kievi pasi protestuesit marrin kontrollin e kryeqytetit.

22 shkurt- Politikanët e Ukrainës votojnë për të hequr Yanukovich dhe caktojnë 25 majin për zgjedhje të reja presidenciale.

23 shkurt- Parlamenti i Ukrainës cakton kompetencat presidenciale për kryetarin e ri, Oleksandr Turchinov, aleat i Tymoshenkos. Protestuesit pro ruse protestojnë në Krimë kundër administratës së re Kievit.

24 shkurt- Qeveria e përkohshme e Ukrainës harton një urdhër për arrestimin e Janukoviç.

25 shkurt- Pro rusi Aleksey Chaly emërohet kryetari i bashkisë Sevastopol e de facto tubimet vazhdojnë në Krimë.

26 shkurt- Tatarët e Krimesë në mbështetje të administratës së re të Kiev përplasen me protestuesit pro Rusisë në rajon.

27 shkurt- Njerëz pro-Kremlinit të armatosur kërkojnë të konfiskojnë

ndërtesat qeveritare në Krimë. Janukoviç i është dhënë strehim në Rusi.

28 shkurt- Njerëz të armatosur drejt kapjes së aeroportit ndërkombëtar Simferopol dhe aeroportit ushtarak në Sevastopol. Këshilli i Sigurimit i OKB-së mban një seancë të jashtëzakonshme me dyer të mbyllura për të diskutuar situatën në Krimë. Moska thotë se lëvizjet ushtarake në Krimë janë në përputhje me marrëveshjet e mëparshme për të mbrojtur pozicionin e saj të flotës në Detin e Zi. Janukoviç bën daljen e parë publike në Rusinë jugore.

1 mars- Dhoma e lartë e parlamentit rus miraton kërkesën e Putinit për të përdorur fuqinë ushtarake në Ukrainë.

2 mars- Një konvoj i qindra trupave ruse shkon drejt kryeqytetit rajonal të Krimesë. Arseny Yatsenyuk, kryeministri i ri i Ukrainës, akuzon Rusinë lidhur me deklaratën e luftës.

3 mars- Flota e Detit të Zi të Rusisë i kërkon marinës së Ukrainës në Sevastopol të dorëzohet ose të përballet me një sulm ushtarak.

4 mars- Në reagimin e tij të parë publik ndaj krizës në Ukrainë, Putin thotë se “vendi i tij ka të drejtë

të përdorë të gjitha mjetet për të mbrojtur qytetarët e saj në Ukrainë lindore”. Të shtëna paralajmëruese, forcat ruse hapin zjarr mbi ushtarë të paarmatosur të Ukrainës, në marshimin drejt një baze ajrore në Sevastopol.

6 mars- Parlamenti i Krimesë voton njëzëri në favor të bashkimit me Rusinë. Disa orë më vonë, Këshilli i qytetit të Sevastopol në Krimë shpall menjëherë bashkimin me Rusinë.

11 mars- BE-ja propozon një paketë masash të liberalizimit të tregtisë për të mbështetur ekonominë e Ukrainës. Parlamenti i Krimesë rajonale miraton “deklaratën e pavarësisë”.

12 mars- Obama takohet me Yatsenyuk në Shtëpinë e Bardhë, një demonstrim i mbështetjes të qeverisë së re të Ukrainës dhe deklaroi se SHBA “do të refuzojë krejtësisht” referendumin e Krimesë.

13 mars- Parlamenti i Ukrainës voton për të krijuar një roje Kombëtare prej 60.000 trupash për të mbrojtur vendin.

15 mars- Anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB-së votojnë me shumicë dërrmuese në mbështetje të një projektrezolutive që dënon referendumin e ardhshëm mbi të ardhmen e Krimesë



si të paligjshëm. Rusia vuri veton ndaj veprimtimit dhe Kina abstenoj.

16 mars- Referendumi i Krimesë shkon përpara, me rezultatet zyrtare që thanë se të paktën 95 për qind e votuesve mbështesin bashkimin me Rusinë.

17 mars- SHBA dhe Evropa vunë ngrirjen e aseteve dhe ndalimin e vizave për individët e përfshirë në shpërndarjen e Krimesë.

18 mars- Putin nënshkruan traktatin për thithjen e Krimesë në Rusi, për herë të parë Kremlini zgjeron kufijtë e vendit që nga lufta e dytë botërore. Kievi thotë se konflikti ka arritur në një "fazë ushtarake" pasi një ushtar ukrainas u qëllua dhe u vra nga persona të armatosur të cilët e kanë bastisur një bazë ushtarake në Simferopol, kjo ishte vdekja e parë e tillë në rajon që në fund të shkurtit nga forcat pro ruse.

19 mars- Aktivistët pro rusë, forcat e vetëmbrojtjes së Krimesë, mesa duket arrijnë në bazën Sevastopol pa përdorur dhunë.

20 mars- Udhëheqësit e BE dënojnë aneksimin e Krimesë në Rusi. BE-ja dhe SHBA zgjerojnë listën e individëve të shënjestruar për sanksione.

21 mars- Pas sanksioneve të SHBA e BE -së synohet rrethi i brendshëm i Putinit, shtohen edhe 12 emra në listën e sanksioneve. Ukraina thotë se kurrë nuk do të pranojë humbjen e Krimesë, ndërsa Moska nënshkruan një projekt ligj për të aneksuar zyrtarisht gadishullin.

22 mars- Ushtarët marrin kontrollin e bazës ajrore të Ukrainës në Belbek, si bazë detare Novofedorovka konfiskohet nga aktivistët pro rusë. Krimea feston bashkimin me Rusinë.

24 mars- Udhëheqësit e Grupit të Shtatë kombeve, takim pa Rusinë, bien dakord të mbajnë takimin e tyre

këtë vit, në vend që të marrin pjesë në një takim të planifikuar G8 dhe pezullojnë pjesëmarrjen e tyre në G8 derisa Rusia të ndryshojë kurs.

25 mars- Oleksandr Turchynov, presidenti i ngarkuar i Ukrainës, urdhëron trupat që të tërhiqen nga Krimea pasi Rusia kapi dhe e aneksoi gadishullin.

27 mars- Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratohet një rezolutë që shpallte aneksimin e Krimesë ruse të Ukrainës të paligjshëm.

29 mars- Gara presidenciale e Ukrainës fillon me ish kryeministren Julia Timoshenko dhe manjati miliarder i ëmbëlsirave Petro Poroshenko që regjistrohet entuziast. Ish kampioni i peshave të rënda Vitali Klitschko tërhiqet nga gara, duke dhënë mbështetjen e tij për Poroshenko dhe duke i bërë thirrje Timoshenko për të bërë të njëjtën gjë.

31 mars- Trupat ruse pjesërisht tërhiqen nga kufiri i Ukrainës në rajonin jugor të Rostovit në Rusi, pas bisedimeve midis ministrit të jashtëm të Rusisë dhe homologut të tij të SHBA. Ndërkohë, Kryeministri Dmitry Medvedev i Rusisë viziton Krimeën, duke premtuar fonde dhe rritje të pagave.

1 prill- NATO njofton pezullimin e "të gjithë praktikave të bashkëpunimit civil dhe ushtarak" me Rusinë.

2 prill- Presidenti i rrëzuar i Ukrainës pranon se ishte "e gabuar" futja e trupave ruse në Krime dhe zotohet të përpiqet të bindë Moskën për të kthyer gadishullin.

6 prill- Aktivistët pro rusë marrin nën kontroll ndërtesat qeveritare në qytetet lindore të Donetsk, Luhansk dhe Kharkiv, duke bërë thirrje për një referendum për pavarësinë. Autoritetet në Ukrainë rimarrin kontrollin e ndërtesave Kharkiv më 8 prill, pas nisjes e një "operacion anti

terror".

11 prill- Kryeministri i përkohshëm i Ukrainës ofron për të dhënë më shumë kompetenca në rajonet lindore, separatistët pro rusë vazhdojnë të zënë ndërtesat në Donetsk dhe Luhansk.

12 prill- Persona të armatosur pro rusë marrin përsipër ndërtesat e stacionit të policisë dhe shërbimeve të sigurisë në qytetin e Slovyansk, 60 kilometra nga Donetsk, si dhe një seli të policisë në Kramatorsk.

13 prill- Forcat speciale të Ukrainës dështojnë për të shpërngulur forcat e armatosura pro ruse në Slovyansk. Një oficer ukrainas dhe një aktivist pro rus vriten në operacion. Ndërkohë, separatistët kapin objekte të këshillit të qytetit në Mariupol dhe në Khartsyzsk.

14 prill- Putin dhe Obama përballë njeri tjetrit gjatë bisedimeve telefonike. Ministrat e jashtëm të BE janë dakord të zgjerojnë listën e atyre që do të goditen me sanksione për rolin që kanë në krizën në Ukrainë.

15 prill- Putin deklaroi se Ukraina është në prag të luftës civile. Politikanët në rajonin e Transdnestrut Moldavisë thirrje Moskës dhe OKB-së që të njohin pavarësinë e saj.

16 prill- Trupat e Ukrainës kthehen prapa nga Slovyansk ndërsa një grup pro rus kap bashkinë e qytetit në Donetsk.

17 prill- Trupat e Ukrainës pengojnë një sulm gjatë natës në Mariupol, duke vrarë tre sulmuesit. Rreth 200 njerëz pastaj demonstronë në qytet kundër Kievit. Putin pranon se forcat ruse u vendosën në Krime gjatë referendumit në mars për t'u bashkuar me Rusinë, por thotë se shpreson që të mos ketë për të përdorur "të drejtën" e tij për të dërguar trupa ruse në Ukrainë. Lav-

rov shpall në Gjenevë një marrëveshje të arritur me Ukrainën, SHBA dhe BE për të "deshkallëzuar" tensionet në Ukrainë.

18 prill- Grupet pro ruse thonë se nuk do të lëvizet nga ndërtesat e pushtuara, qeverinë e Kievit e shohin si të paligjshme. Rusia dënon bisedimet e më shumë sanksioneve. Qeveria e përkohshme e Ukrainës premtion qeverisje të gjerë të pavarur.

20 prill- Një shkëmbim zjarri vdekjeprurës në qytetin lindor të Ukrainës thyen një armëpushim të brishtë të Pashkëve. Rusia deklaroi se është "e zemëruar" me kthimin e dhunës.

21 prill- Protestuesit në Lugansk zotohen për të mbajtur referendumin e tyre lokal mbi autonominë më 11 maj.

22 prill- Në Kiev, nënpresidenti amerikan Xho Bajden thotë se Rusia përballet me "izolim". Urdhërat e Washingtonit për 600 ushtarë në Poloni dhe ish shtetet sovjetike, shtetet baltike. Ukraina urdhëron për të rifilluar një operacion ushtarak kundër separatistëve pro Kremlinit.

23 prill- Rusia thotë se do të përgjigjet në qoftë se interesat e saj janë sulmuar në Ukrainë.

24 prill- Ushtria e Ukrainës nis një sulm mbi Slovyansk. Pesë rebelë janë vrarë sipas Kievit. Forcat speciale kapin përsëri kontrollin e bashkisë së qytetit në qytetin port të Mariupol. Putini thotë se dislokimi i ushtrisë në lindje të Ukrainës nga autoritetet e Kievit është një krim "që do të ketë pasojë". Ushtria ruse fillon ushtrime të reja në kufi me Ukrainën.

25 prill- Kryeministrja ukrainase Arseniy Yatsenyuk akuzon Moskën se "po kërkon të shkaktojë një luftë të tretë botërore". Ushtria ukrainase nis një ofensivë për të rrethuar Slovyansk ndërsa rebelët zotohen "ne nuk do të dorëzojmë qytetin". Fuqitë perëndimore të udhëhequr nga presidenti i SHBA Barak Obama paralajmërojnë se Rusia përballet me sanksione të freskëta. Ata theksojnë se zgjedhjet presidenciale pas 25 majit janë "thelbësore për stabilizimin e vendit". Shtatë vëzhgues ushtarakë të OSBE-së janë arrestuar në Slovyansk.

26 prill- Thuhet se aeroplanët rusë kanë shkelur hapësirën ajrore të Ukrainës, Rusia mohon.

28 prill- Perëndimi vendos sanksione të reja në Moskë. Rusia zotohet për përgjigje "të dhimbshme". NATO thotë se nuk ka shenja të një tërheqje të trupave ruse. Rusia siguron SHBA-në se nuk do të pushtojë Ukrainën.

29 prill- Rusia paralajmëron se sanksionet mund të dëmtojnë interesat perëndimore në sektorin fitimprurës energjetik të Rusisë, dhe mohon se ka trupa në Ukrainë lindore.

30 prill- Kiev vë forcat e tij të armatosura në "gatishmëri luftarake" kundër një pushtimi të mundshëm rus, dhe pranon se policia është "e pafuqishme" për të ndaluar rebelët në qytetet lindore. FMN miraton 17bn \$, paketën e ndihmës për ekonominë e rrethuar ukrainase.

1 maj- Rreth 300 luftëtarë pro ruse kapin zyrën e prokurorit në Donetsk. Rekrutimi është rivendosur për të gjithë njerëzit e Ukrainës të moshës 18-25vjeç.

2 maj- Dita më e përgjakshme që kur qeveria e re erdhi në pushtet. Të paktën 10 të vdekur në sulmin e ushtrisë në Slovyansk. Në qytetin jugor Odessa, 42 të vdekur kur përleshjet mes luftëtarëve pro ruse dhe përkrahësve pro Ukrainës arrin kulmin në një zjarr masiv. Rusia deklaroi planin e paqes në Gjenevë dhe thërret një takim urgjent të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Presidenti amerikan Barak Obama paralajmëron për sanksione të tjera, nëse veprimet e Moskës parandalojnë zgjedhjet presidenciale të 25 majit planifikuar në Ukrainë.

4 maj- Kiev zotohet të zgjerojë operacionet e "anti terrorizmit". Yatsenyuk nis një hetim mbi vdekjet në Odessa.

5 maj- Sulm i ri në Slovyansk. Ministri i Brendshëm thotë se më shumë se 30 rebelë janë vrarë. Gjithashtu janë vrarë katër ushtarë. Rusia paralajmëron "paqja e Evropës është në rrezik". Shefi Ban Ki Moon i OKB,

ofron të ndërmjetësojë personalisht. Perëndimi nis një nxitje të re diplomatike.

6 maj- Rusia kundërshton veprimin gjerman të drejtuar për një takim të ri të paqes. Gjermania thotë se Ukraina është në prag të luftës.

7 maj- Në një njoftim të papritur, Putin miraton zgjedhjet presidenciale të planifikuara të Ukrainës dhe iu bën thirrje rebelëve. Ai thotë se trupat ruse u tërhoqën prapa nga kufiri. Numri i ri i përgjithshëm nga operacionet ushtarake ukrainase qëndron në 14 ushtarakë të vdekur.

8 maj- Rebelët zotohen që të shtypin referendumin pavarësisht thirrjes së Putinit. Rusia zhvillon stërvitjet ushtarake, disa raketa test zjarri, thuhet se aftësitë bërthamore janë në "gatishmëri të vazhdueshme luftarake". NATO thotë se nuk ka shenja të tërheqjes prapa të trupave ruse.

9 maj- Përleshje shpërthejnë në Mariupol, ministri i Brendshëm thotë se ka 21 të vdekur.

10 Maj- Franca dhe Gjermania kërcënojnë për të rritur sanksionet kundër Rusisë në qoftë se zgjedhjet e 25 majit ndërpriten dhe kërkojnë që Kiev t'i japë fund operacioneve "fyese" përpara votimit.

11 Maj- "Referendume" mbahen në krahinat e Lugansk dhe Donetsk. Luftime raportohen rreth Slovyansk, si dhe rebelë përpiqen për të rimarrë TV.

12 Maj- Aktivistët pro Rusë shpallin fitore në një referendum mbi sovranitetin për Ukrainën lindore. Provincat e Donetsk dhe Lohansk votuan për tu shkëputur nga Ukraina.



Autoktonia e shqiptarëve

Pjesë e shkëputur nga libri “Raca shqiptare, Studim Anthropologjik e Historik” (Tiranë 1944), i autorit Jakov Milaj

Pesë vjetë më parë, Shpend Bardhi pat botuar në Përpyjekjen Shqiptare një studim sintetik mbi origjinën e popullit t'onë. 1) Duke marrë për bazë gjurmimet e linguistëve dhe t'albanologëve më të rëndësishëm të botës, ai rrihte me radhë hipotezat e ndryshme që mbështeten sidomos në gjuhë. Kemi shumë rasje që provojnë se origjina e gjuhës së folur nga një popull nuk ka asnjë lidhje me racën së cilës ky popull i përket. Kështu, për shëmbull, s'kanë të bëjnë aspak me arjanizmin, e posaçërisht me racën nordike t'Anglosaksonëve, të gjitha ato fise me ngjyrë të ndryshme që, në të pesë kontinentet e dheut, miren vesh në mes të tyre me anën e anglishtes. Por, për Shqiptarët gjak e gjuhë kanë burim të njëjtë e prandaj studimi i Shpend Bardhit do t'i zinte me shumë të drejtë faqet e kësaj kaptine, sikur mos të donim të kërkojmë edhe ndonjë burim tjetër për të provuar më me siguri se ç'është kjo raca shqiptare duke nxjerë argumentat jo vetëm nga gjuha, por edhe nga arkeologjia, nga mitologjia e nga kërkimet anthropologjike. Linguistët ndahen nga njëri tjetri për origjinën e gjuhës e të popullit t'onë, me gjithë se kurrkush nuk mohon prejardhjen e sajë indo-europjane. Kjo prejardhje është vulosur nga Franz Bopp-i që, nëpër studimet filologjike, ka vërtetuar prerat karakterin arjan të gjuhës e pra të popullit t'onë.

J. G. von Hahn-i, konsulli zë-math i Austris në Janinë, në veprën e tij Albanesische Studien, e gjen shqipen e sotshme bijë t'ilirishtes dhe Gustav Meyer-i, m'i madhi albanolog i shekullit të kaluar, e pranohet dhe mundohet t'a provojë këtë hipotezë. Glotologë të tjerë, ndër të cilët Hirt e Pedersen, nuk e konsiderojnë gjuhën t'onë të rrjedhur nga ilirishtja, por nga thrakishtja; ndërsa albanologu sërb Bariq thotë për të se është një thrakishte e ilirizuar. I famëshmi studjonjës i shqipes, Norbert Jokl, të cilit i detyron shumë Kombi i ynë dhe albanologjia, është i mendimit se shqipja është një gjuhë thrako-ilire. Këtyre mendimeve që nuk qëndrojnë kaq shumë larg njëri nga tjetri i u janë shtuar edhe dy të tjera krejt të ndryshme. Njëri - i August Schleicher-it - e vë shqipen në një degë indo-europjane bashkë me latinishten e me greqishten dhe i përmbledh që të trija nën emrin «grupi pelazgjik»; tjetri - i August Friedrich Pott-it - thot se shqipja është një gjuhë iliro-pelazgjike para-indo-europjane. Por të dyja këto mendime kanë gjetur kundërshtime të forta ndër glotologë. E para është



lënë thuat se më nj'anë; e dyta ka shumë shkencëtarë kundra dhe, në qoftë se mbrënda caqevet të filologjis ka ndonjë mbështetje, nuk pranohet n'asnjë mënyrë nga shumica e historjanvet dhe e arkeologvet. Ndër këto kohët e fundit as historjanët as glotologët nuk po flasin më për një gjuhë e një popull pelazgjik para-indo-europjan, por për një popull proto-ilir arjan, 2) për të cilin as ata vetë nuk dinë se ç'është me saktësi.

Vlejnë pra të mirren në shqyrtim tri hipotezat e para. Të provosh në se Shqiptarët janë prej origjine thrake apo ilire ka rëndësi të veçantë për ne, pse po të pranohet njëra ose tjetra nga këto hipoteza do të thotë të vërtetohet në se Shqiptarët kanë qënë ngulur që prej

kohëve më të lashta në viset që zënë afër e ngjat edhe sot, apo janë të shpërngulur prej ndonjë treve tjetër që ndodhet më afër Detit të Zi. Shpërngulja sjell me vehte edhe përzierje gjaku, pse një popull që largohet prej një toke e vëndoset në një tokë tjetër duhet të ketë pasur përpjekje, me doemos, më parë me fiset që kanë dëbuar e pastaj me fiset që ka gjetur në vëndin e ri. Midis tij dhe këtyre dy grupeve janë bërë kryqëzime që, në përpjestim me kohën e përpjekjes e me numrin e përbërësve të fiseve të huaja, kanë lënë gjurmë shumë pak të dukëshme në brumimin e racës.

A kanë banuar, vallë, stërgjyshët t'anë në viset ku stërnipët e tyre ndodhen edhe sot? A po kanë ardhur këtu prej një treve që gjëndet më nga veri-lindja e që kishte për qëndër Nishin, domethënë prej Dardanis që përputhet me Kosovën e sotëshme, ashtu si ç'thot Jokl-i? A po, më në funt, përpara shkeljes së Sërbevët në Ballkan, banonin më afër Detit të Zi, në trikëndshin Nish - Shkup - Sofie, ashtu si pohojnë Samdfeld-i e Weigand-i? Ndër këto kohët e funtme pesha është duke rënduar më tepër nga ana e iliricitetit të popullit shqiptar dhe nga anasija (autoktonija) e këtij populli. Një albanolog i ri gjerman, Georg Stadtmueller, duke u mbështetur gjithnjë në gjuhë e duke shqyrtuar fjalët e huaja greke e latine të Kishës që kanë hyrë prej kohësh më shqipen, e gjen djepin e fisit t'onë në një vënt që duhet të ndodhet pa tjetër afër Greqis nga njëra anë dhe afër Dalmacis nga ana tjetër, do me thënë n'atë pjesë të buzës lindore t'Adriatikut që banohet edhe sot prej Shqiptarvet. Bilé, siç do të shohim edhe më pas, Autori i përmëndur ngul këmbë për të provuar se në kohën e shkeljes së Sllavëve të hershëm, hapsira jetsore e të parvet t'anë kufizohej në bjeshkët e Shqipëris së veriut e, pikërisht, në malet e në luginat e krahinës së Matit. Përkrahsi m'i math i origjinës ilirike dhe i autoktonis së Shqiptarvet është profesori i Universitetit të Palermos Francesco Bibezzo që njihet prej të gjithë botës si auktoriteti m'i lartë në studimet mesapo-japige. Për të provuar marëdhënjet që në kohë e në hapsirë lidhin shqipen me ilirishten e vjetër dhe, për të vërtetuar vazhdimin historik e gjeografik të Shqiptarvet të sotshëm nga Ilirët e lashtë, ai mbështetet në monumentet dhe inskripcionet mesapike të gjetura në Pulje e në Kalabri, të cilat kanë përgjasim të math me inskripcionet e rralla ilirike që janë zbuluar përkëtej detit Adriatik. Për spjegimin e këtyreve duhet përdorur pa tjetër shqipja e sotëshme e prandaj — arsyeton Bibezzo — kur shqipja dhe ilirishtja janë të barabarta me një gjuhë të tretë, duhet të jenë të barabarta edhe me shoqja shoqen. Në këtë studim shumë të vlershëm, të cilit Shkencëtari i math po i kushton mënt e djersë prej vjetësh, ai arrin duke ndjekur tri rrugë: «I. Rindërton në të gjithë hapsirën sipërfaqen gjuhësore t'ilirishtes së herëshme; II. shtrin dhe thëllon mardhënjet leksikore, fonetike e gramatikore të shqipes me japigo-mesapishten; III. në suazën e përkatsive t'ilirishtes intensifikon kërkesën e ndonjë isoglose që, edhe në se numri i mbeturive gjuhësore është i vogël, të lidhet posaçërisht shqipja me dialektet e folura lashtë në tokën me iliricitet ethnologjik e glosologjik të provuar. Në lidhje me thrakishten, Gjurmënsi i çquar e thjeshtëson mjaft punën, pse ai nxjer prova



të shumta për të vërtetuar se Thrakas e Ilirë kanë folur një gjuhë ti vetme. Çështja e selis ku kanë zënë fill Shqiptarët ka dalë në shesh rastësisht ndër fusha të ndryshme studimi dhe prandaj nuk është rrahur aq sa duhej prej shkencëtarvet. Në këto kushte përfundimet nuk duhen koinsideruar të sakta, pse pikat e nisjes kanë qënë të kuifizuara. «Në heshtjen e shkrimtarvet, thot Ribezzo, problemi u zgjith, si të thuash, negativisht nga Hahn-i n'Albanesische Studien I (1853 faqe 213 e tutje): në qoftë se përjashtohet invadimi sllav, në Mesjetën e lashtë e të ré nuk ka lajme për asnjë tjetër migracion që të ketë mundur të ndryshojë strukturën ethnike e gjuhësore të Shqipëris dhe të cungojë kështu vazhdimin e evolucjonit të shqipes prej ilirishtes. Ky përfundim nuk është pikërisht një circolo vizioso, siç mendon H. Hirt, do me thënë që shqipja është zëvëndësja e ilirishtes vetëm pse Shqiptarët ndodhen në selin e Ilirvet. Sot, mbeturit e pakta gjuhësore t'ilirishtes në fushën toponomastike kanë nisur të gjejnë në shqipen elemente përgjegjse edhe për etimologjinë edhe për fonetikën e tyre.» Më poshtë, një soj si Stadtmueller-i, Profesori i Palermos thot se "po të mendohet që fisi shqiptar vetëm në këtë krahinë (në Shqipërin e sotëshme) është në mardhënje me helenizimin e vjetër të Maqedhonis e t'Epirit, me romanizimin e krahinës danubiane e të Dalmatis, me sllavizimin e Thrakës, rrjeth vetvetiu se kjo bërthëmë (populli Shqiptar) mbetet në vëndin ku gjënde dhe ku historikisht e linguistikisht mund të pritët, në qoftë se ka lidhje kaq të ngushta me thrakishten dhe me ilirishten, të cilat ishin sipërfaqe që shtriheshin për bri njëra tjetrës në kohën romake.»

Një legjendë trimërie në tempullin e historisë së Shqipërisë

Kapedanë dhe prijës shqiptarë në panteon të kombit: Me rastin e 240 vjetorit të lindjes të kapedanit popullor lab Çobo Golëmi

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI
PROF. ASOC. DR. HEKURAN RAPAJ

Kështjella kaone e Labërisë, është një sofër madhështore, ku më të lartë se malet e saj janë kapedanët e saj të shekujve si Çobo Golëmi dhe kapedanë e prijës të tjerë. Historinë tonë shumëshkullore e lartëson qëndrimi heroik dhe kontributi për çështjen kombëtare. Për shekuj me radhë fshatrat e krahinës së Kardhiqit dhe të gjithë trevës së Labërisë kanë lindur me pushkë dhe për pushkë, kanë qenë gjithmonë me armë tek koka, i kanë "folur" çdo armiku e shkelësi të trojeve me gjuhën e zjarrtë të betejave. Por kanë ditur edhe të flasin me gjuhën e mençurisë. Këto treva sikurse gjithë trevat e tjera në veri e në jug të Shqipërisë për shekuj me radhë për mbrojtjen e lirisë kanë derdhur gjak dhe janë bërë sakrificë mbinjerëzore. Pushtuesit osmanë nuk e dinin dhe nuk e njihnin psikologjinë e shqiptarit. Trupat pushtuese me egërsinë e tyre do të "rrisinin" një frymë të rreptë kundërshtare që do t'i shoqëronte për shekuj me radhë. Kjo bënte që shqiptarët të lindnin dhe të vdisnin në luftë me armë në dorë. Historiografia ka të dokumentuar se, shqiptarët ishin ndër popujt "rebelë" nën pushtimin osman që nuk paguanin detyrimet e taksave të Portës së Lartë të Sulltanatit, nuk dërgonin djemtë nizamë dhe vazhdimisht ishin në kryengritje të armatosur. Kryengritjet kundër reformave të tanzimatit janë mjaft të njohura në shumë treva të vilajeteve shqiptare. Këto kryengritje në Jug të vendit ato janë udhëhequr nga kapedanët me zë si Çobo Golëmi, Çelo Picari, Zenel Gjoleka, Hodo Nivica, Balil Nezha, Tafil Buzi, Belul Toto Progonatin, Rrapo Hekalin, etj. Por Çobo Golëmi ka qenë bashkëkohës dhe ka luftuar edhe me kapedanë e luftëtarë jashtë krahinës së Labërisë si me ata të krahinës së Çamërisë, Lumit të Vlorës, Mallakastrës e deri në Berat. Kapedanë të kryengritjeve të kohës së Ali Pashë Tepelenës, u pasuan më vonë me bëma të kapedanëve e prijësve në kryengritje të tjera të mëvonshme. Ata kishin



lindur në luftë dhe "nuk e dinin" se ç'ishte paqja. Paqja kishte qenë një eveniment disi i harruar e i rrallë. Pas saj kishte gjithmonë një plan luftimi, një dredhi apo mashtrim pushtimi, një betejë një përgjakje. Paqja e qetësia në këtë pjesë të vilajeteve shqiptare kishte qenë e përkohshme, ndërsa luftërat kishin qenë të përhershme.

Luftëtar i spikatur për lirinë kombëtare

Një figurë kombëtare e spikatur e kryengritjeve kundër reformave të Tanzimatit, ishte padyshim Çobo Golëmi Mustafaraj nga Golëmi i Kurveleshit. Çobua lindi dhe u burrërua në Golëm të Kurveleshit, një fshat që historikisht ka mbajtur peshën të konsiderueshme në luftërat kundër pushtuesve si portë për të hyrë në Kurvelesh. Ai erdhi në jetë në një familje me tradita luftarake e patriotike të hershme për breza me radhë. E gjithë treva kishte parë burra të cilët i dilnin për zot vatanit sa herë që ai shkelej nga i huaji. Patriotët atdhetarë lebër, fushëbardhas, zhu-latas, golëmas dhe gjithë krahina e Kardhiqit e më gjerë shikonin tek Çobo Golëmi luftëtarin e rritur dhe kalitur në beteja. Çobo Golemi Mustafaraj ka lindur në Golem të Kurveleshit në mëhallën e Gjinuke në vitin 1774, pra 240 vjet më parë në fshatin kala prej natyre, ku “më shumë është përdorur baruti se sa mielli”, sikurse thotë një fjalë e urtë e popullit të kësaj treve. Çobo Golëmi ishte i biri i Mustafa Hitos; ndërsa nënën e kishte nga Kuçi. Poeti popullor lab lindjen e djalit të parë të oxhakut të Mustafa Hitos, do këndonte: “Në gosti gjithë Golemi/Lindi Çobo Mustafai/U tund dheu u tund vendi/Gëzohet Ali Pashai..”. Mustafa Hitua kishte pesë djem: Çobon, Hasanin, Hiton, Duron dhe Hodon. Është fakt historik se vëllai i Çobos, Hitua është vrarë kur shërbente në Oborrin e Ali Pashë Tepelenës dhe varrin e ka në Janinë në vendin që edhe sot quhen “varret e Goleme”. Vëllai tjetër i tij Durua ishte bajraktari ose flamurtari i çetës së tij (bajrak-flamur – nga gjuha osmanllishte). Luftëtarin e Kurveleshit Çobo Golëmi ishte kthyer në një legjendë për gjithë trevën jugore shqiptare e më gjerë. Ai kishte një jetë aktive luftarake. Varri i tij gjendet në fshatin Golem pranë pusit të fshatit ngjitur me portën e baçes së Haxhi Sinanit. Çobo Golëmi Mustafaraj aktivitetin e ka filluar që në moshë të re në oborrin e Ali Pashë Tepelenës së bashku me vëllain e tij Hiton. Gojëdhëna popullore ka përcjellë brez pas brezi figurën e Çobo Golëmit, bekimin e Sheh Mehmetit, tek burimi i Rehovës, pranë Golëmit: “Çobo rrofsh e përparofsh, fisi jetoftë më shumë se lisi, mbarësi kurbeti dhe mos u përziëni në hakë të fshatit”. Kudo ku ishin kuvendet ishin edhe prijësit e kapedanët e tyre. Kështu tradita e kuvendeve kalonte nga Senica në Rrepet e Agait në Taroninë, Picar, Delvinë, Shtëpëz, Cepo, Kuç dhe në gjithë Labërinë. Parija dhe mençuria, trimëria dhe urtësia transmetoheshin brez pas brezi në breza. Këtë e kish mësuar dhe trashëguar edhe Çobo Golëmi, që më shumë se miqtë e njohën armiq të në fushëbetejë. Çobua kishte lindur në vendin e kapedanëve. Tradita luftarake në jug të vendit ka qenë shumë e hershme, që prej kohës së Gjergj Arianit Komnenit (Golemit) i cili i thyen keqas turqit në 1435 në Qafën e Skërficës si dhe në grykat e Rehovës e Kaparielit, që janë historikisht tre portat e mundshme për të marrë Kurveleshin nga jugu dhe nga lindja. Ushtria osmane në këto treva provoi një nga humbjet më të rënda nga goditjet e kapedanëve lebër. Ndoshta është legjendë që dhe sot pas pothuaj gjashtë shekujsh gojëdhëna flet se varri i Gjergj Komnenit gjendet në Golëm te bregu i fisit Mustafarajve dhe që quhet “varri i Gjergjit”. Faktikisht historianë e arkeologë nuk kanë mundur ende të hulumtojnë në të vërtetat e shekujve të kësaj treve të lashtë.

Guximtari që fliste me pashanë e Janinës...

Shekujt XVII dhe XVIII lidhen me shturjen e Perandorisë Osmane, ku feudalët shqiptarë u forcuan e zgjeruan çifligjet e tyre, ku lindën edhe pashallëqet e para shqiptare, siç ishte ai Ali Pashë Tepelenës në Janinë.



Aftësitë dhe energjitë ambicioze, duke përdorur dhunën, dinakërinë, lidhjet familjare bëri që të krijohej një formacion shtetëror i fuqishëm, autonom me rregull, qetësi e zhvillim ekonomik e kulturor. Veziri i Janinës pati përkrahjen e mbështetjen e shumë lebërve të cilët u rritën, u stërviten dhe i shërbyen si Çelo Picari, Belul Toto, Hito e Çobo Mustafaraj, Abas Aliko etj. Sundimi dhe pasuria u ngrit mbi bazën e ndëshkimit e deri në mizori. Fakt është se të gjithë e lavdëronin pashain e Janinës edhe pse ai nuk i besonte as gazetarëve, as oborrtarëve e as të huajve. Vetëm Çobo Golëmi në një bashkëbisedim të hapur pati guximin t'i thoshte pashait të Janinës: “Ku më dëgjoni ju Pasha në majë të malit”. Pashai u bë serioz dhe zbriti nga kali: “Pa he çdo më thuash?” -Me ç'shoh dhe me ç'dëgjoj “Lum ai që di ta hedhë, mjerë ai që s'di ta dredhë, vaj me det ai që mbet!” . Aliu nuk i harroi fjalët e mençura të luftëtarit lab që ja tha si “me të kënduar labçe”. Këta vlerësoheshin nga oborri i njohur i Janinës edhe me tituj dhe me grada e që ngelën besnik deri në luftën e fundit më 1820-1822, ku u bë edhe qëndresa këmbëngulëse, në ishullin e Liqenit të Janinës. Lebërit besnikë deri në fund nuk i lëshuan istikamet, ku u vranë pesë fushëbardhas e pesë golemas, ku midis tyre ishte dhe Hito Golëmi Mustafaraj. Këta luftëtarë të rënë në beteje u vendosën në hyrje të Janinës, ku dhe dhanë jetën. Edhe sot ky vend thirret me emrin “varret e goleme” ose “varret e kapedanëve të Labërisë”.

Rritur e burrëruar në beteja

Një ndër provat madhore të heroizmit të kapedan Çobo Golëmit, këtij lisi tashmë me përmasa shekullore është kryengritja e viteve 1832-1833 kundër ekspeditës së Emin Pashait. Mbrojtja e trevës bëhej me parapritë duke i dalë kundërshtarit disa kilometra më përpara. Burra të kuvendeve e të jataganit nga treva labe, por edhe nga ajo e Lunxhërisë, dhe fshatrave përreth Gjirokastrës, të besimit mysliman e të krishterë, u pozicionuan në rrëzë të malit të Buretos, në fshatin



Peshkëpi e deri në Kakavi. Beteja ka qenë e ashpër me humbje në të dy krahët si të luftëtarëve shqiptarë ashtu edhe të pushtuesve osmanë. Trupat e Emin Pashës nën komandën e dy subajëve madhorë Hasan Beu e Shishko Mirjallai u tërhoqën në fshatin Guvernë të Paleopogonit, por luftëtarët e kapedan Çobos i sulmuan vrullshëm me shpata osmanët luftuan trup me trup shtëpi më shtëpi duke shkaktuar dëme të mëdha të konsiderueshme. Thirrjes luftarake për tu dorëzuar e ndërlikuan edhe më keq situatën luftarake. Në këtë luftë ranë në fushëbetejë Duro Mustafaraj, vëllai i kapedan Çobos, dhe u plagos rëndë Sulo Mustafaraj i biri i Çobos. E megjithatë në hidhërim e sipër për vëllanë dhe shokët e tjerë që ju vranë kapedan Çobua vendos të sulmojë furishëm që të kapë të gjallë komandantin e ekspeditës osmane. Faktikisht luftëtarët e Labërisë kapën të dy oficerët Hasan beun dhe Shishko Mirjallain. Kjo ngjarje bëri bujë dhe ngeli në vargjet popullore letrare: "O halldup shallvare gjerë,/Në ta zënça dot Guberë,/Do të bëj njëmijë të prerë,/Zu Hasan beun të gjallë,/Edhe Shishko Mirjallanë,/I preu për të vëllanë,/Atë Duro Mustafanë,/Dhe për shokët që ju vranë". Çobo Golëmi me veti e karakteristika të labit kapedan prijës e tepër i prerë në vendimmarrje bëri që robërit të nxirreshin para luftëtarëve shqiptarë duke i gjykuar sipas rregullave ushtarake të kohës për krimet që kishin kryer. Lëvdatat dhe premtimet për ofiqe e pasuri nga robërit nuk shkonin përpara gjeneralit pa grada kapedan Çobo Golëmit. Nuk vonoi dhe bëmat e këtij kapedani të Labërisë i mësoi edhe porta e lartë. Zemërata e Sulltanit ishte si dallgëzimi i egër i Marmarasë dhe për betejën e humbur si dhe vrasjen e dy subajllarëve të lartë kërkoi që kokën e kapedanit Çobo Golëmit t'ia çonin në sini në Kostandinopojë. Koka e Çobo Golëmit kërkohet në Konstantinopojë vetëm një dekadë pasi prenë Ali pashë Tepelenën. "Ndere" të kësaj natyre u bëhej vetëm kapedanëve të famshëm. Shpejt fama për trimëri dhe urti do ta kalonte trevën dhe krahinat e jugut dhe do të njihet edhe në veri të vendit. Kujtesa historike shkon tek ajo periudhë kur kapedan Gega (populli i trevës labe e mbiquajti të tillë) viziton kapedanin e Labërisë Çobo Golëmi. Në sheshin e fshatit që quhej "sheshi i dyluftimit", që në fakt ishte një shesh stërvitjeje u bë edhe një ballafaqim i dy trimave që përfundoi me

përqaqim vëllazëror:

Lisi me dega t'ergjenta, çë mbylli Valiun brenda...

Ajo që dikur tregohet nga bashkëluftëtarë të Çobo Golëmit është arkivuar në trashëgiminë e brezave. Kështu një luftëtar lazaratas në fillim të shekullit të kaluar ju tregonte për bëmat e kapedanit, birit të Çobos Shahinit si dhe të nipit Refatit, se në Luftën e Guverit më 1833, dinamika e betejës lidhet pikërisht me prijësin e forcave shqiptare. Në luftime të ashpra u vranë shumë luftëtarë dhe midis luftëtarëve u vra edhe Duro Çolëmi Mustafaraj që ishte edhe flamurtar i forcave shqiptare. Në një moment Çobua pyet: "pse nuk po shikoj flamurin të valëvitet. Besnikët që e rrethonin nguronin t'i tregonin për vrasjen e vëllait të tij sepse i trembeshim reagimit të tij për hakmarrje dhe nuk donim që kryetrimi të vihej në rrezik për jetën e të vritej. Por në një interval luftimi çibukçiu i tij personal që i mbushte nargjilenë me duhan i thotë: "Të rrosh vet se Durua u vra". Në këtë moment therës të fortë vjen komanda e kapedanit: "o burra për mbi ta". Kushtrimi i forcave shqiptare të Çobo Golëmit në pak minuta eliminoi tetëdhjetë e dy osmanë dhe kapin dy oficerë madhorë. Kur njërit prej oficerëve madhorë ju bë gjyqi në vend, madhori tjetër osman duke parë shokun e tij se si e mbylli jetën, i frikësuar dhe në panik i lutet prijësit Çobo Golëmit në kërkim të dëshirës së fundit: Pasha, në oxhakun tim thyhen 300 luge floriri dhe zotëroj 30 çifliqe (simbolizim i rrjetit miqësor dhe pasurisë). Falmë jetën të të fal gjysmat e çifliqeve e gjithë sendet e bakërta. Kapedani i përgjigjet: - Ne shqiptarët nuk e lajmë gjakun me para, por me gjak, por ty një favor do ta bëj, trupi nuk do të ta copëtojë, por do të nderoj me prerje të menjëhershme të kokës dhe trupin do ta dorëzoh tek askerët e tu të Anadollit. Ngjarja është përjetuar: "Tek taborni me melqinja,/Çobo pallë vetetima,/kapedan "Se bëre mirë",/Më dysh e ndave hordhinë,/o ju pleqtë e venit tënë,/Mbani Çobo Mustafanë,/Mos vritet na pret takanë,/Kush i thot për të vëllanë,/Për atë Duro bajraktarë/Këceu në istikamë,/Tetëdhjetë e dy të vranë,/Hasan bej Karaferene,/Edhe Shishko Mirjallanë,/Çu preu kokën me pallë,/Lisi me dega t'ergjenta,/E mbyllë Valiun brenda,/Se që Çobo Mustafai,/E bën sa u tund saraji.." Vera e vitit 1847 njihet për shpërthimin e kryengritjes më të madhe që tronditi themelet e sundimit osman. Kundërpërgjigjja ishte me grusht të hekurt ndaj reformave centralizuese të Portës së Larte. Kësaj kryengritjeje i parapriu krijimi i "Besëlidhjes Shqiptare" me 1846 dhe mblodhjet në Picar, Taroninë, Progonat, Mesaplik, etj. . ku dolën edhe kapedanët e prijësit si Çobo Golëmi e që zjarrin kryengritjes së pari e ndezi Labëria. "U mblodh e gjithë burrëria/Gjeneralët natyralë/Kishin ardhur nga krahina/edhe e gjithë parësia/Idris Sulli nga Fushëbardha/Ardhur Çobua nga Golemi/Këta u mblodhën e thanë/Nizamë neve nuk vemi/...". Kapedanët e saj ju sulën qendrave kryesore administrative osmane dhe përcollën mesazhin e çlirimit për gjithë vilajetet shqiptare.

Kapedan i aristokracisë labe – simbol i bashkimit të besimeve

Historinë e Çobo Golëmit e shkroi populli, në vargun e poetëve dhe këngëtarëve anonimë. Kapedanët në Labëri ishin krenarë e të drejtë që nuk bënin pazar me historinë e paraardhësve të tyre. Për figurën e Çobo Golëmit Mustafarait duke përlogaritur fisnikërinë e aristokracinë labe si dhe pozitën shoqërore të fisit të tij vargëzon: "Porta me bojë të verdhë,/Marrë për mostër n'Inglietë.."(Angli), që shpreh lidhjet e kësaj familjeje me botën perëndimore, me fuqinë më të madhe të kohës Anglinë. Më tej ajo që

nuk e mbajnë dot arkivat e mban vargu i Labërisë: "Lisi me degë të rënda,/E mbylle valiun brënda", që do të thotë se: Kryengritja popullore e vitin 1847-1848 e gjen kapedan Çobo Golëmin në krye të asaj, kryengritje që përfshinte gjithë kazanë e jugut të vendit. Kapadan Çobua kishte marrëdhënie vëllazërore me të krishterët, të cilët kishin luftuar krah për krah kundër osmanëve. Çobo Golëmi ishte një kapedan autoritar në gjithë kazatë jugore dhe kjo dukej edhe në kuvende të Labërisë e të Delvinës: "Nga Himara e Muzinë,/Çobua nga Labëria,/Te rrapi ndënë Delvinë,/Seç u mblodhë kristjania,/Çobua me fustanellë,/Çepeziu si ombrellë,/Jatagani për mënjane,/Delvinë mblodhi kazanë"... Kjo vërtetohet që ndasitë besimtare nuk ekzistonin përpara fateve të atdheut dhe uniteti vëllazëror shqiptar ishte parësor në kuvendet e Labërisë e më gjerë.

Zemërgjerësia -Urtësia e Kapedanit- Beteja në duel

Në legjendën popullore ka një fakt që mbart një mesazh të madh: Kundërshtarët e qëllojnë kapedanin për ta eliminuar të paguar nga osmanët dhe në interes të tyre, por nuk ja arritën qëllimit. Besnikët e tij të luftës kapin personin që donte ta vriste dhe ja çojnë për ta gjykuar kapedan Çobua. Ai me një maturi dhe urtësi i thotë, "mos vra mua vëllain tënd, por kemi pushtuesit hasëm ndaj bashkoku me ne për qëllimin e përbashkët", duke e falur. Ai i bëri thirrje për të luftuar bashkë kundër osmanëve në Skërficë, në Senicë, Sopot, Delvinë, Peshkëpi, Himarë etj. Në një mbledhje të parësisë së Kurveleshit u vendos zhvendosja në një zonë në afërsi të Rrëzomes e fushës së Vurgut për kushte më të mira jetese, me drithëra, kripë, kullota etj. Por në këtë kuvend kapedan Çobua nuk ishte pjesëmarrës, për angazhime të tjera. Pasi Kuvendi popullor mori vendim Çelo Picari u thotë: "Për këtë vendim do të pyesim edhe dajo Çobo Golëmin. Trimi i Picarit Çelo Picari ishte djali i hallës së Çobo Golëmit. Por Çelo Picari kuvendoj me Çobo Golëmin, ai u thotë: "Kur vijmë në qafë të Skërficës për në Kurvelesh i lajmë edhe këmbët e kuajve tek dy burimet e Qafës së Skërficës. Qëllimi është që balta e moçalishteve të mos vijë lart në Kurvelesh. Tani më dëgjoni mirë o kapedanë: "A do donit që atë baltë kur të vdisni ta hidhni mbi trupin tuaj?" Pas këtij debati projektvendimi për të transferuar banorët e Labërisë dhe Kurveleshit në zonat më të ulëta u anulua dhe jeta vazhdoi e vazhdon edhe në male". Prandaj "Kur dil Çobua në Skërficë,/Të ligjtë bijnë e vdisnë,/Hajde sylesh i syleshit./Del i pari i Kurveleshit,/Del Çobua me pallë sheshit.."

Duke dëgjuar për famën e kapedanit popullor një subaj osman e fton në duel por asnjëri nuk e njihte personalisht njeri-tjetrin. Lajmësit caktuan edhe ditën dhe orën e duelit në kryeqendrën e vilajetit në Janinë. Çobua kishte ardhur më herët dhe priste në një kafene; ndërsa roja personale e tij, një luftëtar që e quanin Halil rrinte tek porta e kafenesë. Subaji osman vjenme tërsëllimë duke bërëtitur, sharë e ofenduar Çobo Golëmin. Luftëtar i thotë tek porta e kafenesë: "Unë jam Çobua". Kështu në duel doli subaji osman dhe roja personale e Çobos. Kur afroreshin për t'u ndeshur Çobua duke parë zotësinë dhe shkathtësinë në duel të subajit osman i tërheq vëmendjen që nga publiku në osmanllisht: "dale të mbaroj me këtë ku vete ti?". Instinktivisht oficeri osman kthen kokën mbrapa, e ndërsa kuajt afroreshin dhe luftëtar lab duke përfutur nga pavëmendja e oficerit osman mbi kalin e zbukuruar e eliminon në mënyrë të rrufeshme. Ngjarja ka ngelur në vargje: "Kapetan Çobo Golëmi,/Të kërkon takim osmëni,/Si kini bërë mos bëni,/Se do ngrihete sulltani,/Dhe me te ju dot se hani,/ Do t'u prishete vatani./Bir o bir Çobo Golëmi,/Kur flasje merrte zjarr kuvendi/



Të piqet turku për shkëmbi,/Të vdesim siç kemi lerë,/Me pallë ngjeshur përherë,/Se gjakun edhe nderë,/Me para s'e kemi blerë..". Por edhe pse vargëzimi ka erë barot, zjarr e luftë ka dhjetëra e qindra fakte që flasin e tregojnë për mençuri, urtësi e mature para se të shkohej në beteja që për kohën kanë qenë të pashmangshme.

Dëshmor në fushën e nderit me jatagan në dorë

Ra tërmet e u tund vendi,/Thonë lufton Çobo Golemi,/Kapedan i këtij vendi

Pesë vjet pas kryengritjeve të mëdha antitanzimatit osmanët erdhën sërish për tu "takuar", "me mall" me kapedanin popullor Çobo Golëmi. Ishte viti 1853. Sulmi ishte me forca të mëdha kundër kryeneçëve dhe të panështruarve. Në përballje të përgjakshme të pabarabartë ra në fushën e nderit me jatagan në dorë kapedani famëmadh Çobo Golëmi Mustafaraj. Bashkë me kapedan Çobon në luftë kundër osmanëve bie edhe Sulo Mustafaraj i biri i Çobos. Trimëritë e kapedanit populli i ka skalitur: "Ra tërmet e u tund vendi,/Thonë u vra Çobo Golemi,/Kapedan i këtij vendi./Kapedan qe kur kish lerë,/Që lufton me pallën nxjerre,/Ben dyfek me sadrazemnë,/Rritur nëpër bejlerë...". Vetëm në një shekull oxhaku fisnik i kapedanëve të Çobo Golëmit ka pasur 11 martirë, që kanë rënë që të gjithë në luftëra për mbrojtjen e atdheut. I pari është Hito Golëmi Mustafaraj, i cili u vra bashkë me Ali pashën më 1822 në ishullin e Janinës dhe më vonë memoria kombëtare nuk harron gjakun e të rënëve të shenjtëruar që nderohen në panteonin e kombit si Çobo Golëmi, Duro Golëmi, Sulo Golëmi si dhe më vonë edhe Ismaili, Shefqeti, Merqezi, Neziri, Neki, Brahushi e Xhemil Golëmi Mustafaraj. Labëria ka qenë një vatër zjarri e përhershme. Nuk ka ngjarje politike e ushtarake, që nga lashtësia që të mos kenë thënë fjalën e vet me kontributin e tyre të shquar bijtë e Labërisë. Në malet e ashpra të saj gjithë pushtuesit romakë, bizantinë, osmanë dhe pushtuesit e tjerë njohën një popull luftarak e të panështrueshëm lehtë. Prandaj populli dhe kujtesa historike nuk i harron bijtë e vet dhe trevat që kanë shkruar epope lavdie. Në përvjetorë, por jo vetëm luftëtarët me aktivitetin atdhetar e patriotik meritojnë nderim e vlerësim, dekorime apo vendosje emërtime të rrugëve, shkollave e institucioneve që të përjetësojnë sakrificat e patriotizmit dhe të traditës luftarake shqiptare.

100 VJET NGA LUFTA E MADHE

Luftëtarë shqiptarë në Luftën e Parë
Botërore, të cilët luftonin për lirinë e
vendit të tyre



Burimi: Nationaal Archief, Collectie Eerste Wereldoorlog. (158-1766)
Groep bewapende Albanen die als ongeregelde troepen voor de vrijheid
van hun land vechten onder Italiaans commando